



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM
2009-2011

Janar 2009

Tabela e Permbajtjes

HYRJE	4
A.1 ROLI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM (PBA)	4
A.2 PBA DHE STRATEGJIA KOMBETARE PER ZHVILLIM DHE INTEGRIM	4
A.3 PROCESI I PERGATITJES SE PBA-SE 2009-2011	4
TABELA 1 FAZAT E PERGATITJES SE PBA-SE	5
A.3.1 Rishikimi i Politikes se Programit (RPP)	5
A.3.2 Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit (PSHIP)	5
A.3.3 Kerkesat per Shpenzime te PBA	6
A.3.4 Kerkesat Shtese per Shpenzime te PBA	6
A.3.5 Miratimi i PBA	6
A.3.6 Roli i Ministrise se Financave	6
A.3.7 Roli i Komitetit te Planifikimit Strategjik	6
B. KUADRI MAKROEKONOMIK, FISKAL DHE BUXHETOR PER PERIUDHEN 2009-2011	7
B.1 VLERESIMI I PERGJITHSHEM MAKROEKONOMIK PER VITIN 2008	7
B.1.1 Sektori Real:	8
B.1.2 Sektori Monetar e Financiar:	11
B.1.3 Sektori i Jashtem:	12
B.2 PARASHIKIMET MAKROEKONOMIKE DHE FISKALE 2009-2011	13
B.2.1 Parashikimet Makroekonomike:	13
B.2.2 Parashikimi i Te Ardhurave:	15
B.4.2 Shperndarja e Shpenzimeve Buxhetore	20
C. PROGRAMET BUXHETORE AFATMESME TE MINISTRIVE TE LINJES	23
C.1 MINISTRIA E SHENDETESISE	23
C.1.1 Misioni i Ministrise:	23
C.1.2 Qellimet e Politikes:	23
C.1.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	23
C.1.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE SHENDETESISE	31
C.2 MINISTRIA E DREJTESISE	31
C.2.1 Misioni i Ministrise:	31
C.2.2 Qellimet e Politikes:	31
C.2.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	32
C.2.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE DREJTESISE	42
C.3 MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE	43
C.3.1 Misioni i Ministrise	43
C.3.2 Qellimet e Politikes:	43
C.3.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	44
C.3.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE MJEDIST, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE	50
C.4 MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERJITIKES	50
C.4.1 Misioni i Ministrise:	50
C.4.2 Qellimet e Politikes:	50
C.4.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	51
C.4.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERJITIKES	64
C.5 MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME	64
C.5.1 Misioni i Ministrise:	64
C.5.2 Qellimet e Politikes	64
C.5.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	65
C.5.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE PUNEVE TE JASHTME	71
C.6 MINISTRIA E MBROJTJES	71
C.6.1 Misioni i Ministrise:	71
C.6.2 Qellimet e Politikes	72
C.6.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	72
C.6.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE MBROJTJES	90
C.7 MINISTRIA E PUNES, CESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA	91
C.7.1 Misioni i Ministrise:	91
C.7.2 Qellimet e Politikes	91
C.7.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	91
C.7.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE PUNES, CESHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TE BARABARTA	102

C.8 MINISTERIA E INTEGRIMIT	102
C.8.1 Misioni i Ministrise	102
C.8.2 Qellimet e Politikës	102
C.8.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	103
C.8.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE INTEGRIMIT EUROPIAN	109
C.9 MINISTERIA E TURIZMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE	109
C.9.1 Misioni i Ministrise:	109
C.9.2 Qellimet e Politikës:	109
C.9.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	110
C.9.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE TURIZMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE	119
C.10 MINISTERIA E FINANCEVE	120
C.10.1 Misioni i Ministrise:	120
C.10.2 Qellimet e Politikës:	120
C.10.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	120
C.10.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE FINANCEVE	137
C.11 MINISTERIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT	137
C.11.1 Misioni i Ministrise:	137
C.11.2 Qellimet e Politikës:	137
C.11.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	138
C.11.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT.	151
C.12 MINISTERIA E ARSIMIT DHE SHKENCES	151
C.12.1 Misioni i Ministrise:	151
C.12.2 Qellimet e Politikës:	151
C.12.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	152
C.12.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE MINISTRISE E ARSIMIT DHE SHKENCES.	169
C.13 MINISTERIA E BRENDSHME	170
C.13.1 Misioni i Ministrise:	170
C.13.2 Qellimet e Politikës:	170
C.13.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	171
C.13.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE BRENDSHME	191
C.14 MINISTERIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT	192
C.14.1 Misioni i Ministrise	192
C.14.2 Qellimet e Politikës	192
C.14.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise	193
C.14.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE MINISTRISE SE PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT	219
C.15 PROKURORIA E PERGJITHSHME	219
C.15.1 Misioni i Prokurorise se Pergjithshme	219
C.15.2 Qellimet e Politikës	219
C.15.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE PROKURORISE SE PERGJITHSHME	222
C.16 ZYRA E ADMINISTRIMIT TE BUXHETIT GJYQESOR	222
C.16.1 Misioni i ZABGJ	222
C.16.2 Qellimet e Politikës	222
C.16.4 KOMENTET LIDHUR ME KERKESEN PER PBA 2009-2011 TE ZABGJ	225
D. TAVANET PERFUNDIMTARE TE SHPENZIMEVE BUXHETORE TE PBA 2009-2011, PER MINISTRITE E LINJES DHE INSTITUCIONET QENDRORE	226
TAVANET E SHPENZIMEVE BUXHETORE TE PBA, PER MINISTRITE, NE NIVEL PROGRAMI	227
TAVANET E SHPENZIMEVE BUXHETORE TE PBA, NE NIVEL MINISTERIE/INSTITUCIONI QENDROR.	229

PERMBLEDHJE

Dokumenti perfundimtar i Programit Buxhetor Afatmesem (PBA) 2009-2011 perben finalizimin e fazes se pare dhe te dyte te procesit te pergatitjes se Dokumentit te Programit Buxhetor Afatmesem 2009-2011, proces ky i iniciuar permes dy vendimeve te Komitetit te Planifikimit Strategjik (KPS) per percaktimin e Kuadrit Makro-Fiskal 2009-2011 dhe Tavanave Pergatitore te PBA 2009-2011.

Kete vit kerkesat buxhetore te ministrive te linjes jane paraqitur ne menyre me te plote ne krahasim me vitin e kaluar, si edhe brenda afateve te percaktuara ne Udhhezimin per Pergatitjen e Buxhetit. Si edhe nje vit me pare, i gjithë procesi eshte drejtuar dhe koordinuar nga Grupi per Strategji Buxhet dhe Integrim (GSBI), i cili eshte ngritur ne cdo ministri linje ne baze te Urdherit te Kryeministrit Nr.78, Date 08.05.2006, ku nje rol te vecante ka luajtur koordinatori i GSBI-se (Sekretari i Pergjithshem) ne cdo ministri. Gjithashtu, ne vitin 2008 ne programin buxhetor afatmesem 2009-2011 u perfshine per here te pare institucionet qendrore te Prokurorise se Pergjithshme dhe Zyres se Administrimit te Buxhetit Gjyqesor.

Dokumenti i PBA 2009-2011 paraqet ne detaje qellimet, objektivat dhe produktet e programeve te seciles prej Ministrive te Linjes, ne nivel programi per vitet 2009, 2010 dhe 2011. Keshtu, ky dokument ka mundur te realizoje per nje kuader afatmesem lidhjet mes qellimeve dhe objektivate te politikave, me alokimin e burimeve buxhetore, perkatesisht ne nivel programi.

Eshte e rendesishme per t'u theksuar fakti se, me rritjen progresive te vemendjes kushtuar procesit te PBA-se, kapaciteti i menaxhimit te tij do te permiresohet vazhdimisht me kalimin e kohes. Gjithashtu, Sistemi i Planifikimit te Integruar dhe vecanerisht miratimi i Strategjise Kombetare per Zhvillim dhe Integrim, do te sherbejne mjaft per te forcuar procesin e PBA-se, nepermjet sigurimit te informacionit te nevojshem ne nivel strategjik te politikave.

Ne vijim, dokumenti i PBA 2009-2011 eshte i strukturuar ne pese kapituj:

- ➔ *Kapitulli i Pare* pershkruan rolin e PBA-se si nje instrument i menaxhimit te shpenzimeve publike, pjese perberese e Sistemit te Planifikimit te Integruar si edhe, termat kohore qe procesi i PBA-se ka ndjekur gjate vitit buxhetor.
- ➔ *Kapitulli i Dyte* pershkruan Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal per periudhen 2009-2011, per cdo Ministri Linje/Institucion Buxhetor te miratuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik ne Korrik 2008.
- ➔ *Kapitulli i Trete* paraqet ne menyre te permbledhur informacionin e siguruar nga Ministrite e Linjes lidhur me PBA 2009-2011 dhe konkretisht qellimet, objektivat dhe produktet e politikave per secilin prej programeve te tyre per vitet 2009, 2010 dhe 2011.
- ➔ Ndersa, *Kapitulli i Katert* parashton tavanet perfundimtare te PBA-se 2009-2011 ne nivel institucioni dhe programi. Tavanet per vitin 2009 reflektojne limitin e shpenzimeve te miratuara nga Kuvendi me ligjin nr.10025 date 27.11.2008 "Per buxhetin e vitit 2009".

Hyrje

A.1 Roli i Programit Buxhetor Afatmesem (PBA)

1. Programi Buxhetor Afatmesem eshte nje instrument operacional per menaxhimin e shpenzimeve publike dhe nje komponent kyc i Sistemit te Planifikimit te Integruar. Ai eshte rezultat i dy proceseve: Rishikimit te Politikave dhe Planifikimit te Shpenzimeve. Planet e shpenzimeve hartohen nga ministrite e linjes brenda burimeve qe Qeveria ka ne dispozicion. Ky dokument perdoret per te informuar Kuvendin e Shqiperise dhe publikun e gjere lidhur me planet e shpenzimeve te Qeverise per tre vitet e ardhshme te cilat do te cojne ne arritjen e objektiveve politike te Qeverise. Ai percakton kontekstin afatmesem te Buxhetit Vjetor.
2. Qellimet kryesore te PBA jane:
 - *Inkurajimi i efektivitetit, eficences dhe ekonomise ne kryerjen e shpenzimeve publike;*
 - *Lidhje e drejtperdrejte ndermjet prioriteteve strategjiko-politike te Qeverise me shperndarjen e burimeve publike dhe kryerjen e shpenzimeve publike;*
 - *Promovimi i disiplines fiskale duke mundesuar qe shpenzimet publike te planifikohen brenda nje kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;*
 - *Zgjerimi i vizionit te procesit buxhetor duke siguruar qe programet e shpenzimeve te planifikohen ne nje periudhe afatmesme (3 vjecare)*
3. Dokumenti i PBA hartohet nga Ministria e Financave dhe i jep mundesine Keshillit te Ministrave per te zhvilluar nje kuader te qarte burimesh brenda periudhes afatmesme qe do te sherbeje si baze per planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale publike.
4. Gjithashtu, ai i sherben ministrive te linjes pasi mundeson percaktimin prej tyre te politikave dhe programeve ne nje strukture koherente si dhe mundesine per te percaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit te burimeve te disponueshme, ne menyre qe burimet financiare te mund te alokohen tek programet prioritare ne periudhen afatmesme.
5. Duhet theksuar gjithashtu qe procesi i hartimit te PBA eshte i orientuar mbi bazen e performances. Perparesite e kesaj menyre te re te konceptimit te planifikimit te shpenzimeve konsistojne ne perftimin e:
 - *Kontributit te qarte te produkteve ne permbushjen e objektiveve te politikave;*
 - *Produkteve te matshme;*
 - *Aktiviteve te kostueshme.*

A.2 PBA dhe Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim

6. Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim, me nje horizont planifikimi prej 7 vitesh, percakton strategjite dhe synimet afatshkurtra dhe afatgjata per te gjitha sektoret, bazuar ne nje vizion kombetar. Ne SKZHI perfshihen gjithashtu aspiratat per Integrimin European dhe ate ne NATO.
7. Per procesin e PBA-se 2009-2011, elementi strategjik i PBA-se u siguria nepermjet konsultimit te strategjive sektorale dhe ndersektorale pergjate procesit te Rishikimit te Politikave se Programit – percaktimi i qellimeve dhe objektiveve per cdo program shpenzimesh te cdo ministrie. Ky proces u ndermorr nga nje bashkepunim i ngushte ndermjet Ministrise se Financave, Ministrise se Integrimit dhe Departamentit te Bashkerendimit te Strategjive dhe Koordinimit te Ndhimes se Huaj, ne Kryeministri.

A.3 Procesi i Pergatitjes se PBA-se 2009-2011

8. Tabela 1 paraqet ne menyre te permbledhur hapat kryesore ne procesin e pergatitjes se PBA-se 2009-2011, te ndermarre ne perputhje me kalendarin e Sistemit te Planifikimit te Integruar te miratuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik ne mbledhjen e dates 19 Janar 2008.

Tabela 1 Fazat e Pergatitjes se PBA-se

FAZAT	KOHA	PERSHKRIMI
1. Kuadri makroekonomik, vendosja e prioriteteve dhe pergatitja e taveve te PBA-se per secilen ministri	Tremujori I	<ul style="list-style-type: none"> • Pergatitja e taveve te pergjithshme dhe vendosja e treguesve makroekonomike permes parashikimit makroekonomik. • Identifikimi i prioriteteve te politikave dhe zerave me ndikim te rendesishem ne shpenzime e te ardhura (pagat, transfertat vendore, programet e reja, projektet kryesore te investimeve publike) • Vendosja e taveve per gatitore te PBA-se • Pergatitja e Udhezimit per Pergatitjen e Buxhetit.
Qeveria miraton parashikimin makro, tavanet e pergjithshme dhe tavanet per gatitore te PBA-se 3-vjecare per cdo ministri		
2. Rishikimi i Politikave se Programit (RPP).	Tremujori II	<ul style="list-style-type: none"> • Ministrite vendosin politikat per cdo program dhe identifikojne qellimet dhe objektivat e programit.
3. Plani i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit (PSHIP).	Tremujori II	<ul style="list-style-type: none"> • Brenda taveve te percaktuara, ministrite zhvillojne PSHIP duke identifikuar produktet dhe duke i kostuar aktivitetet ne baze te fondeve ne dispozicion per cdo program. • Dorezimet e PBA-se jane plotesisht te reflektuara ne Planin e Integruar te Ministrise.
Qeveria miraton draftin teknik te PBA		
4. Pergatitja e Buxhetit	Tremujori III	<ul style="list-style-type: none"> • Pergatitja e Udhezimit Plotesues per Pergatitjen e Buxhetit. • Ministrite paraqesin buxhetet e detajuara.
Qeveria miraton draftin perfundimtar te PBA dhe projektligjin e buxhetit dhe i dergon ne Kuvend perkatesisht per informim dhe miratim		
5. Shqyrtimi ne Kuvend	Tremujori IV	<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtimi dhe miratimi i ligjit vjetor te buxhetit nga Kuvendi.

Shenim: PBA publikohet ne fillim te vitit pas miratimit te ligjit vjetor te buxhetit nga Kuvendi.

A.3.1 Rishikimi i Politikave se Programit (RPP)

9. Nevoja kryesore per nje manaxhim efektiv te financave publike eshte percaktimi i qarte i politikave. Per politikat e reja kjo mund te arrihet nepermjet zbatimit te nje procesi te mire te percaktimit te politikave, domethene nepermjet permiresimit te hartimit te politikave.
10. Ne praktike, procesi i hartimit te politikave nuk ka qene gjithmone i frytshem persa i perket qartesise se politikave. Prosesi i PBA-se merr nje rendesi paresore ne perpjekjet e qeverise per te lidhur buxhetin vjetor me politikat e tij. Per te arritur kete, politikat duhet te jene te qarta, te kuptueshme dhe te rishikohen rregullisht nepermjet nje procesi te rishikimit te politikave se programit i cili eshte i integruar me procesin e planifikimit te shpenzimeve dhe investimeve, percaktimit te kostove dhe pergatitjes se buxhetit.

A.3.2 Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit (PSHIP)

11. Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit eshte pjese e planifikimit strategjik dhe pason Rishikimin e Politikave se Programit. Ai perfaqeson pjesen kryesore te procesit te pergatitjes se PBA-se. PSHIP ndermerret ne kontekstin e politikave makroekonomike dhe veçanerisht te nevojës per stabilitet fiskal.
12. Ai realizohet gjithashtu ne kontekstin e prioriteteve strategjike te Qeverise dhe te qellimeve dhe objektiveve te politikave te percaktuara per çdo sektor, domethene, nepermjet Rishikimit te Politikave se Programit. PSHIP reflekton menyren se si Qeveria deshiron t'i alokoje burimet e saj per secilin sektor.
13. Nje hap i rendesishem per te garantuar qe procesi i PSHIP te jete ne perputhje me kuadrin makroekonomik e fiskal dhe prioritetet strategjike te Qeverise, eshte vendosja e taveve te shpenzimeve, qe perben kufirin maksimal qe mund te shpenzohet ose te planifikohet per t'u shpenzuar, per nje qellim te caktuar. PSHIP

ndermerret nga ministrite e linjes duke perdorur sistemin e informatizuar te Ministrise se Finances per Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve te Programeve.

A.3.3 Kerkesat per Shpenzime te PBA

14. Pas perfundimit te fazes se PSHIP, ministrite e linjes paraqesin kerkesat perkatese per shpenzime te PBA. Keto kerkesa duhet te jene rigorozisht brenda taveve te percaktuara nga Komiteti i Planifikimit Strategjik prane Keshillit te Ministrave, si dhe te jene te miratuara nga titullaret respektive.

A.3.4 Kerkesat Shtese per Shpenzime te PBA

15. Kerkesat shtese per shpenzime te PBA paraqesin nevojat per financim te programeve perkatese te ministrive te linjes, te cilat nuk mund te mbuloen brenda taveve te percaktuara nga Ministria e Financave. Keto kerkesa perfshijne gjithashtu nje shpjegim se pse ministria perkatese nuk mund te siguroje nje kursim eficient nga Programet e tjera.
16. Miratimi i Kerkesave Shtese te PBA, per nje ose me shume ministri, kerkon rialokimin e burimeve nga programet me pak prioritare te ministrive te tjera te linjes, e cila vendoset nga Keshilli i Ministrave.

A.3.5 Miratimi i PBA

17. Pas shqyrtimit nga ana e Ministrise se Financave te kerkesave per shpenzime te PBA dhe kerkesave shtese te PBA, materiali i permbledhur ne Draft Dokumentin e PBA paraqitet per shqyrtim prane Komitetit te Planifikimit Strategjik dhe me pas per miratim perfundimtar prane Keshillit te Ministrave.

A.3.6 Roli i Ministrise se Financave

18. Roli i Ministrise se Financave eshte kryesor dhe shume i rendesishem. Nuk eshte roli i saj primar per te analizuar objektivat dhe qellimet e politikave te sektorit; kjo eshte pergjegjesia e Keshillit te Ministrave. Roli i saj kryesor eshte qe, gjate fazes se Rishikimit te Politikave se Programit, te siguroje qe politika, objektivat dhe qellimet jane te percaktuara qarte dhe se programet mbeshtetese dhe rezultatet e synuara do te plotesojne objektivat dhe qellimet e politikave ne nje menyre qe krijon vlere per para qe do te thote ne menyre ekonomike, eficiente dhe efektive.
19. Ndersa, roli i Ministrise se Financave ne fazen e Planifikimit te Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit eshte i dyfishte. Detyra e saj e pare eshte t'i beje propozime Keshillit te Ministrave per Tavanet e Pergjithshme te Shpenzimeve dhe Tavanet Pergatitore te PBA-se. Ndersa detyra e saj e dyte ka te beje me vleresimin e faktit nese ministrite po arrijne eficencen, efektivitetin dhe ekonomi ne zbatimin e programeve, gje te cilen ajo e mban parasysh kur ben propozim e Taveve Pergatitore te PBA-se.

A.3.7 Roli i Komitetit te Planifikimit Strategjik

20. Komiteti i Planifikimit Strategjik eshte nje strukture e krijuar prane Keshillit te Ministrave e cila kryesohet nga Kryeministri. Roli i ketij Komiteti eshte thellesisht koordinues dhe vendimmarres, pasi te gjitha propozimet e rendesishme qe kane te bejne me Sistemin e Planifikimit te Integruar ne pergjithesi, dhe Programit Buxhetor Afatmesem ne vecanti, kalojne detyrimisht per shqyrtim prane ketij Komiteti perpara se te marrin miratimin perfundimtar.
21. Ne procesin e pergatitjes se PBA, Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Keshilli i Ministrave luajne nje rol paresor ne drejtim te miratimit te nje sere etapash te rendesishme te tilla si:
 - *Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal per periudhen e PBA*
 - *Tavanet Pergatitore te PBA*
 - *Kalendari i SPI*
 - *Dokumenti Perfundimtar i PBA.*

B. Kwadri Makroekonomik, Fiskal dhe Buxhetor per Periudhen 2009-2011

22. Kwadri fillestar makroekonomik e fiskal për periudhën 2009-2011 është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave. Kwadri makroekonomik e fiskal përgatitet me qëllim që të ofrohet informacion për përcaktimin e përparësive strategjike, shpenzimeve agregate, synimeve në lidhje me të ardhurat dhe defiçitin, si edhe për përcaktimin e taveve për të filluar procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në nivel ministrie. Kwadri fillestar makroekonomik e fiskal miratohet nga Komiteti i Planifikimit Strategjik në muajin e parë të çdo viti, dhe është subjekt rishikimi dhe përditësimi në dy momente kyç gjatë vitit; në muajin Maj, përpara finalizimit të PBA-së dhe të taveve të PBA-së për shpenzimet, dhe në muajin Shtator, përpara dërgimit në Parlament të projekt buxhetit të shtetit.
23. Kwadri makroekonomik e fiskal për periudhën 2009-2011 përbëhet nga dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë paraqiten vlerësimet mbi zhvillimet ekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2008, dhe pjesa e dytë trajton parashikimet e treguesve kryesore makroekonomik, parashikimin e burimeve në dispozicion të qeverisë dhe shpërndarjen e tyre për periudhën 2009-2011.

B.1 Vlerësimi i Përgjithshëm Makroekonomik per vitin 2008

24. Gjatë vitit 2008 ekonomia shqiptare shënoi ecuri pozitive, si në drejtim të rritjes ekonomike ashtu dhe për sa i takon stabilitetit makroekonomik e thellimit të reformave strukturore, drejt një ekonomie më eficiente. Rritja reale ekonomike për periudhën Tetor 2007 – Shtator 2008, e llogaritur nëpërmjet *Produktit të Brendshëm Bruto Tremujor*¹ (treguesit të ri statistikor publikuar nga INSTAT), shënon nivelin e 9.9 përqind. Ndërsa vlerësimet e Ministrisë së Financave për rritjen vjetore të vitit 2008 (janar – dhejtor 2008), në pritje të rezultateve nga llogaritjet e INSTAT, tregojnë për një nivel në intervalin 7 deri në 8 përqind, e cila do të jetë objekt rishikimi në muajt e mëvonshëm. Niveli i përgjithshëm i cmimeve qëndroi i ankoruar brenda kufijve optimalë prej 2 deri në 4 përqind. Norma mesatare e inflacionit për vitin 2008 arriti në 3.4 përqind dhe ai i fund-vitit nivelin e 2.2 përqind.
25. Evidentohet performancë e lartë në sektorin e ndërtimit, mbështetur dukshëm prej investimeve publike në infrastrukturë. Sektorët e shërbimeve, industrisë nxjerrëse e përpunuese dhe ai i energjisë elektrike kanë putur gjithashtu një ecuri të kënaqshme. Nga njëra anë norma e papunësisë ka shënuar rënie graduale, e nga ana tjetër vihet re një rritje e konsiderueshme e pagave thuajse në të gjithë sektorët e ekonomisë. Gjithashtu ecuria në sektorin e bujqësisë paraqitet krejt e normalizuar gjatë këtij viti, pas një periudhë tepër të vështirë të krijuar një vit më parë takoni pasojë e faktorëve klimaterik ekstremalisht të pafavorshëm.
26. Sistemi ynë financiar kaloi mjaft mirë impaktin e goditjeve direkte e më të forta nga problemet financiare të gjeneruara në tregjet financiare ndërkombëtare. Duke marrë në konsideratë këto goditje, ecuria e sistemit monetar e financiar të vendit paraqitet mjaft e mirë. Depozitat me afat në lekë e në valutë të rezidentëve deri në në muajin tetor janë rritur përkatësisht me 7.1 e 11.4 përqind, duke çuar në një rritje prej rreth 6 përqind të ofertës monetare (M3). Në të njëjtën kohë, huaja për ekonominë ka vazhduar të zgjerohet me ritme optimale, ndërsa niveli i kredive me probleme mbetet i ulët. Kredia për ekonominë deri në muajin tetor është rritur me 31.5 përqind, ku rreth 2/3 e kësaj rritje e atribuohet biznesit, ndërsa pjesa tjetër individëve. Këto zhvillime reflektojnë zgjerimin e biznesit dhe rritjen e të ardhurave e të nivelit të jetesës të individëve. Diferenca midis normave mesatare të interesit për depozitat dhe atyre të huasë e bonove të thesarit është ngushtuar lehtësisht, duke reflektuar rritjen e konkurrencës dhe zhvillimin në tregun financiar. Në të njëjtën kohë monedha vendase, Leku, vazhdon të tregojë një qëndrueshmëri tepër të lartë ndaj valutave.

¹ Produkti i Brëndshëm Bruto Tremujor është një produkt statistikor i publikuar së fundmi nga INSTAT. Ministria e Financave, si një përdorues kryesor i statistikave ekonomike, shprehet se ky produkt statistikor ka një vlerë informative të pazëvendësueshme nga treguesi tjetër dhe inkurajon e mbështet INSTAT në vazhdimin e publikimit të këtij treguesi e përmirësimin e mëtejshëm të tij. Metodologjia për llogaritjen e këtij treguesi bazohet në Manualin e Llogarive Kombëtare Tremujore të hartuar prej Fondit Monetar Ndërkombëtar. Objektivi i këtij treguesi është matja e lëvizjeve/ndryshimeve nga tremujori në tremujor të PBB, informacion ky tepër i rëndësishëm për aktorët apo vendimarrësit në ekonomi. Ky tregues, i bazuar mbi këtë metodologji, nuk ka për qëllim dhe nuk mund të ketë një precizion të lartë në matjen e ndryshimeve vjetore (ritjen reale vjetore) të PBB, por ai mund të japë tendencat e saj. Matja precize dhe përfundimtare e rritjes reale vjetore të PBB kryhet vetëm nga Llogaritë Kombëtare Vjetore në INSTAT, gjë e cila bazohet tërësisht në metodologji standarte të përdorura në mbarë botën për këtë qëllim, sic janë Sistemi Evropian i Llogarive – 1995 (ESA 95) dhe Sistemi i Llogarive Kombëtare – 1993 (SNA 93). Ndërsa Ministria e Financave ka mandatin të kryejë vetëm parashikime të rritjes ekonomike vjetore, si për vite të kaluara për të cilat nuk është publikuar ende një vlerësim nga Llogaritë Kombëtare Vjetore të INSTAT, ashtu dhe për vitet e ardhshme.

27. Reformat fiskale të ndërmarra në vitet 2007 - 2008 kanë bërë që sistemi tatimor në Shqipëri të jetë më lehtësuesi dhe nxitësi për zhvillimin e biznesit krahasuar me vendet e rajonit. Politikat e taksave ka qënë në funksion të prioriteteve strategjike të Qeverisë. Paralelisht me këtë qëllim shpërndarja e barrës së taksave në mënyrë më të barabarte dhe me pak deformuese, ka qënë element dhe tipar tjetër i rëndësishëm i kësaj reforme fiskale.
28. Shqipëria, tashmë në një “momentum” mjaft pozitiv ekonomik renditet një prej të paktave vendeve të cilat për gati një dekadë rresht kanë patur një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme prej mbi 6 përqind. Kjo konfirmohet më së tepërmi gjatë dy viteve të fundit të cilat ishin një “stress-test” real për ekonominë, ku me gjithë problemet në energjinë elektrike, thatësisrën në bujqësi e së fundmi krizën financiare e rënien ekonomike në tregjet e huaja, rritja ekonomike e vendit tonë vazhdon të jetë në të njëjtat nivele të larta. Krahas progresit teknologjik e reformimit strukturor të ekonomisë, implementimi gjatë këtij dyvjecari i një serë politikash e reformash efikase makroekonomike, të orientuara qartë nga “filozofia” e stimulimit të rritjes ekonomike nëpërmjet nxitjes së ofertës agregate, i kanë dhënë një shtysë mjaft të fortë ekonomisë. Ndjekja e politikave makroekonomike efektive si dhe thellimi i mëtejshëm i reformave ekonomiko-strukturorë, krahas proceseve të tjera të natyrshme në të cilat po kalon ekonomia si progresi teknologjik, akumulimi i kapitalit e ristrukturimi i ekonomisë drejt një ekonomie gjithnjë e më eficiente, do të sigurojnë që kjo ecuri ekonomike të vazhdojë e tillë edhe të paktën për një të ardhme afatmesme.
29. Situata jo e mirë ekonomike që pritet për një numër të konsiderueshëm të ekonomive më të mëdha botërore, sigurisht që përbën riskun më të prekshëm edhe për ekonominë tonë. Megjithatë, duke qënë se promotori kryesor i zhvillimit e rritjes ekonomike qëndron në tregun dhe në aktorët ekonomik të brendshëm, kjo e vendos ekonominë shqiptare në një pozicion relativisht të mbrojtur ndaj këtyre zhvillimeve jo të favorshme. Gjithashtu autoritetet përgjegjëse për hartimin dhe ndërmarrjen e politikave makroekonomike janë plotësisht të fokusuar në zhvillimet e mëtejshme dhe janë plotësisht të angazhura që nëpërmjet këtyre politikave të injektojnë stimuj shtesë në ekonomi në kohën dhe në masën optimale, me qëllim lehtësimin sa më tepër të efekteve negative që mund të vijnë nga zhvillimet negative të tregjeve të huaja. Deri më tani, krahas një mbikqyrje më të afërt të sistemit bankar, politika monetare është materializuar kryesisht në ruajtjen e stabilitetit të cmimeve, si dhe mbikqyrjen e likuiditetit e ruajtjen e ekuilibrave financiarë të sistemit, duke mbajtur të pa ndryshuar normën bazë të interesit. Megjithatë në rast të një kontraktimi të ekonomisë, investimeve apo konsumit, e në rast të një rënie shqetësuese të nivelit të përgjithshëm të cmimeve, vlen për t’u theksuar që politika monetare shihet si një instrument tepër i gatshëm, efektiv e me mjaft hapësirë manovrimi, për të amortizuar efektet negative e për t’i dhënë impulse nxitëse ekonomisë.
30. Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2008 shënoi një ecuri mjaft pozitive. Është mbajtur e konsoliduar më tej stabiliteti makroekonomik i vendit dhe ka vazhduar reformimi strukturor drejt një ekonomie më eficiente. Në tërësinë e tij, zhvillimi ekonomik gjatë vitit 2008 ka ndjekur kuadrin e parashikuar në programin e zhvillimit ekonomik afatmesëm të vendit.
31. Rritja me rreth 2.6 për qind e investimeve të huaja direkte për periudhën janar – shtator 2008 edhe pse në dukje një rritje modeste, duhet theksuar që kjo vjen pas një rritje tepër të lartë prej rreth 80 përqind të IHD një vit më parë si dhe vlen për t’u theksuar se thujtse të gjitha hyrjet e IHD gjatë vitit 2008 janë të natyrës “green-field”, përkundrajt një pjese të mirë të IHD në formën e privatizimeve të realizuara një vit më parë. Këto zhvillime në investimet e huaja direkte shihen si një indikator mjaft domethënës i cili reflekton qartë edhe njëherë nxitjen e bërë biznesit dhe konsolidimin e stabilitetit makroekonomik e të besimit në ekonominë shqiptare. Zhvillimet pozitive në biznesin vendas, kanë dhënë efektet e tyre në nxitjen e punësimit e rritjen e të ardhurave të disponueshme të familjeve. Të ardhurat në rritje, kanë mbajtur në nivele të larta konsumin familjar e kësajsoj edhe kërkesën e brendshme agregate duke i dhënë një impuls të dytë nxitës rritjes së ofertës e duke krijuar kështu potenciale të reja për rritje e zhvillim të mëtejshëm ekonomik.

B.1.1 Sektori Real:

32. Indeksi tremujor i prodhimit², gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2008 ka regjistruar një rritje mesatare reale prej rreth 16.6 % kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

² Indeksi tremujor i prodhimit llogaritet mbi bazën e Anketës Tremujore të Ndërmarrjeve (ATN) të realizuar nga INSTAT. Ai mat ndryshimin real në prodhimin e ndërmarrjeve jo-bujqësore.

33. Prodhimi në sektorin e industrisë, gjatë kësaj periudhe nëntëmuajore ka rezultuar mesatarisht rreth 32.8 përqind më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Aktivitetet e përfshira në këtë sektor, industrina nxjerrëse, përpunuese dhe ajo e prodhimit të energjisë elektrike, gazit e ujit, kanë patur një rritje mesatare në terma vjetorë respektivisht prej rreth 19, 16 e 62 përqind (Tabela 1, Graf 1).

Tabela 1: Indeksi i prodhimit (Ndryshimi vjetor)

	T1-2008	T2-2008	T3-2008
	T1-2007	T2-2007	T3-2007
Industri	30.7	30.4	37.3
<i>Nxjerrëse</i>	12.1	39.1	5.4
<i>Përpunuese</i>	15.2	13.3	18.7
<i>Energji elektrike, gaz, ujë</i>	40.1	41.2	103.9
Ndërtim	92.2	103.8	65.7
Shërbime	15.0	7.8	13.3
Total	18.0	12.8	19.1

Burimi: Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve - INSTAT

34. Kjo e fundit i atribuohet një situatë mjaft të mirë në sektorin e energjisë elektrike, krahasuar me një periudhë tepër të vështirë të kaluar një vit më parë. Ndërsa rritja në industrinë nxjerrëse i atribuohet kryesisht vazhdimësisë së ritmeve të larta të rritjes së eksporteve të mineraleve, gjë e cila konfirmohet edhe nga Statistikat e Tregtisë së Jashtme³. Nga ana tjetër këto zhvillime pozitive mbështeten edhe nga indeksi i numrit të të punësuarve⁴ si dhe ai i fondit të pagave të paguara gjithsej⁵. Numri i të punësuarve në sektorin e industrisë në total është rritur mesatarisht rreth 6.8 përqind kundrejt nëntë muajve të parë të vitit 2007 (Tabela 2), ndërsa fondi i pagave me rreth 19.4 përqind (Tabela 3, Graf 2).
35. Sektori i ndërtimit ka qenë sektori me performancën më të lartë gjatë këtij viti me një rritje prej rreth 87 përqind dhe kjo rritje i atribuohet në masën më të madhe investimeve publike kryesisht në infrastrukturën rrugore. Numri i të punësuarve në këtë sektor është rritur me rreth 36 përqind, ndërsa fondi i pagave të paguara ka patur një rritje prej rreth 63 përqind.

Tabela 2: Indeksi i nr. të punësuarve (Ndryshimi vjetor)

	T1-2008	T2-2008	T3-2008
	T1-2007	T2-2007	T3-2007
Industri	8.1	7.4	4.9
<i>Nxjerrëse</i>	14.3	10.5	-5.3
<i>Përpunuese</i>	6.9	6.9	7.4
<i>Energji elektrike, gaz, ujë</i>	10.0	8.2	0.3
Ndërtim	36.2	36.9	34.3
Shërbime	14.7	11.6	12.9
Total	15.3	13.6	12.8

Burimi: Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve - INSTAT

36. Gjithashtu edhe sektori i shërbimeve⁶ ka patur zhvillime të kënaqshme gjatë këtyre nëntë muajve të vitit 2008. Ai ka regjistruar një rritje mesatare të shërbimeve të shitura prej rreth 12 përqind, rritje të numrit të të punësuarve prej rreth 13 përqind dhe një rritje rreth dy herë më e lartë në pagat e paguara gjithsej në këtë sektor.

³ Statistikat e Tregtisë së Jashtme për mallrat e eksportuar e importuar vlerësohen nga INSTAT mbi bazën e të dhënave doganore.

⁴ Indeksi i numrit të të punësuarve vlerësohet nga INSTAT mbi bazën e ATN dhe mat ndryshimin në numrin e të punësuarve në cdo tremujor.

⁵ Indeksi i pagave vlerësohet nga INSTAT mbi bazën e ATN dhe mat ndryshimin në cdo tremujor të fondit të pagave të paguara gjithsej.

⁶ Përfshihen shërbimet e Tregtisë, Hotelerisë, Transportit jo-rrugor, Postave e Telekomunikacionit.


Tabela 3: Indeksi fondit të pagave (Ndryshimi vjetor)

	T1-2008	T2-2008	T3-2008
	T1-2007	T2-2007	T3-2007
Industri	24.8	22.0	11.5
Nxjerëse	29.7	20.5	7.8
Përpunuese	28.1	19.9	19.4
Energji elektrike, gaz, ujë	14.8	28.1	-7.4
Ndërtim	76.1	55.7	56.2
Shërbime	34.8	36.1	26.4
Total	37.1	32.3	24.0

Burimi: Anketat Tremujore e Ndërmarrjeve - INSTAT


37. Numri i të punësuarve në total për të gjithë sektorët e ekonomisë që përfshihen në këtë indeks është rritur me rreth 14 përqind, ndërsa fondi i pagave ka patur një rritje prej rreth 31 përqind gjë con në një hamendësim edhe për një rritje të konsiderueshme të pagave në ekonomi.

Graf 1: Indeksi i prodhimit (Ndryshimi vjetor)



38. Në zhvillimet pozitive të ekonomisë reale duhet theksuar edhe një ecuri tashmë e normalizuar në sektorin e bujqësisë, pas një viti tepër të vështirë në këtë sektor për shkak të kushteve tepër të disfavorshme klimaterike. Rritja e prodhimit bujqësor i është kthyer ritmeve normale të saj dhe bazuar në anketat periodike të realizuara nga MBUMK vlerësohet që për këtë vit ajo do të jetë rreth nivelit 3 përqind.

Graf 2: Punësimi dhe fondi i pagave në sektorët e ekonomisë



39. Norma e papunësisë ka ndjekur një trend rënës përgjatë vitit 2008. Në fund të tremujorit të tretë këtij viti ajo ka zbritur në nivelin e 12.6 përqind nga 13.2 përqind që shënonte në fund të vitit 2007. Në vitet 2005 e 2006 kjo normë ishte përkatësisht 14 e 13.9 përqind. Në vijim të reformave për rritjen e efencës e për përmirësimin e shërbimit të administratës publike, numri i të punësuarve në sektorin shtetëror ka vazhduar të ndjekë një trend të lehtë rënës. Që prej tremujorit të tretë të vitit 2005 e deri në tremujorin e tretë të vitit 2008 numri i të punësuarve në sektorin shtetëror është ulur me rreth 5 %. Nga ana tjetër, paga mesatare në këtë sektor që prej gjysmës së dytë të vitit 2005 e deri në fund të vitit 2007 është rritur vazhdimisht, rritje e cila arrin në rreth 37 përqind.

B.1.2 Sektori Monetar e Financiar:

40. Gjatë këtij viti, e në veçanti gjatë tremujorit të tretë të tij, sistemi ynë financiar u përball me një valë tepër të fortë vështirësish financiare të gjeneruara nga disa prej tregjeve më të mëdha financiare ndërkombëtare. Duhet theksuar që sistemi ynë financiar dhe institucionet e tij e kaluan majft mirë këtë situatë dhe kjo përbën një test real të stabilitetit të konsoliduar që gëzon ky sistem. Kështu, nëse marrim parasysh këto vështirësi financiare me të cilat po përballen disa prej ekonomive më të zhvilluara, mund të themi që zhvillimet gjatë këtij viti në sistemin tonë monetar e financiar kanë qenë relativisht mjaft pozitive.
41. Paraja e gjerë në ekonomi e shprehur prej agregatit monetar M3 deri në tetor të vitit 2008 ka patur një rritje prej 6 përqind që nga dhjetori i vitit të kaluar. Kjo rritje ka qenë kryesisht rrjedhojë e rritjes së depozitave me afat në lekë e në valutë të rezidentëve. Depozitat me afat në lekë kanë patur një rritje prej 7.1 përqind duke kontribuar kështu me rreth 2.4 pikë përqindje në rritjen e M3. Ndërsa depozitat në valutë kanë vazhduar përsëri të regjistrojnë rritjen krahasimisht më të lartë, si dhe të kenë kontributin më të madh në rritjen e ofertës së parasë në ekonomi. Këto depozita për periudhën janar – tetor janë rritur me rreth 11.4 përqind e rrjedhimisht kanë kontribuar me rreth 3.9 pikë përqindje në ecurinë e M3. Ndërsa zhvillimet në dy agregatët e tjerë të cilët klasifikohen si “para” në sistemin bankar, përkatësisht pararaja jashtë bankave dhe depozitat pa afat të rezidentëve, kanë lëvizur në kahe të kundërta dhe në magnituda të tilla efekti rezultant i të cilave ka qenë neutral në paranë e gjerë - M3. Paraja jashtë bankave për periudhën janar – tetor 2008 ka patur një rritje prej rreth 6.7 përqind e rrjedhimisht një kontribut prej 1.4 pikë përqindje në ecurinë e M3, ndërsa nga ana tjetër depozitat pa afat dhe llogaritë rrejdhëse janë pakësuar me rreth 13.7 përqind duke patur një kontribut negativ prej -1.6 në agregatin M3.
42. Në të njëjtën kohë, huaja për ekonominë ka vazhduar të zgjerohet me ritme relativisht të larta, ndërkohë pretendimet neto të sistemit bankar ndaj qeverisë së përgjithshme janë reduktuar lehtësisht. Deri në tetor të këtij viti kredia për ekonominë është rritur me rreth 31.5 përqind që nga fundi i vitit të kaluar, duke arritur në rreth 35 përqind të PBB nga rreth 29 përqind në fund të vitit 2007. Ndërsa kreditimi vetëm për sektorin privat është rritur me rreth 30.6 përqind. Kjo rritje reflekton edhe një periudhë të mirë e të sigurtë që po kalon biznesi, i cili në zgjerim të aktivitetit të tij e investimeve ka rritur kërkesën për kapital. Thuajse dy të tretat e rritjes së kredisë për ekonominë, rreth 20 pikë përqindje, vjen prej rritjes së huasë të marrë prej biznesit, ku pjesa dërrmuese është përdorur për investime. Një periudhë ekonomike të mirë e të sigurt duket se po kalojnë edhe individët, huaja e marrë prej të cilëve kontribuon me rreth 11 pikë përqindje. Gjithashtu situata e mirë ekonomike e individëve reflektohet dhe nga rritja e aftësisë së tyre për të kursyer, dëshmuar prej rritjes së depozitave me afat në lekë e në valutë për për të gjitha maturitetet. Rritja e kursimeve në ekonomi i hap rrugë investimeve të reja e rrjedhimisht potencialeve të reja për zhvillim ekonomik të mëtejshëm.
43. Pavarësisht ritmeve të larta të rritjes së kredisë për ekonominë, kreditë “e këqija” mbeten në nivele të ulta. Deri në tetor të 2008 kreditë e këqija⁷ përbënin vetëm 4.1 përqind të totalit të kredisë për ekonominë ose rreth 1.4 përqind të PBB.
44. Norma mesatare të interesit të depozitave gjatë këtij viti kanë pësuar një rritje fare të lehtë krahasuar me një vit më parë. Ndërsa normat mesatare të huasë si dhe ato të bonove të thesarit kanë patur një ulje krahasuar me një vit më parë. Kjo tendencë reflekton rritjen e konkurrencës dhe të efencës së sistemit bankar, duke cuar në uljen e spreadit të bankave para depozituese. Gjatë këtij viti, politika monetare e bankës qendrore sa i takon instrumentit të saj kryesor, normës bazë të interesit, ka qenë e pandryshuar, duke reflektuar një situatë makroekonomike gjërësisht në ekuilibër.

⁷ Përfshihen huatë nënstandarte, hua të dyshimta dhe hua të humbura. Huatë e humbura në fund të tremujorit të tretë përbënin vetëm 0.95 përqind të totalit të huasë.

45. Norma mesatare e inflacionit për periudhën janar - nëntor 2008 ishte 3.5 përqind duke qenë sërisht brenda intervalit target prej 3 + 1 përqind të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni vjetor ka ardhur në rritje që nga muaji qershor i vitit 2007, ka arritur vlerat e tij më të larta në muajt Gusht, Shtator e Tetor të këtij viti duke kaluar lehtësisht mbi kufirin e sipërm prej 4 përqind të intervalit, për të zbritur sërisht në nivelin rreth 3 përqind në fund të vitit 2007. Rritja në çmimet e produkteve ushqimore, e ndikuar pjesërisht nga pakësimi i prodhimit të brendshëm bujqësor dhe nga rritja e çmimit të drithërave dhe produkteve të tjera ushqimore në tregun botëror, ishin shkaktarët kryesorë të ndryshimit të prirjes së normës vjetore të inflacionit gjatë vitit 2007. Në muajt e parë të vitit 2008 u shfaqën sërisht presione inflacioniste të të njëjtës natyrë si një vit më parë. Si pasojë e rritjes së çmimeve të një serë mallrash të ardhura nga importi, vecanërisht çmimet e produkteve ushqimore dhe të karburante të cilat përbëjnë dhe pjesën kryesore të importeve të vendit, gjatë gjysmës së parë të vitit 2008 inflacioni mesatar ishte në nivelin 4 përqind. Më tej, gjatë periudhës korrik – nëntor 2008, këto presione inflacioniste të ardhura nga tregjet ndërkombëtare u shuan gradualisht dhe në nëntor të këtij viti norma e inflacionit vjetor shënoi vlerën e 2.6 përqind.
46. Ecuria e kursit të këmbimit gjatë periudhës janar – nëntor 2008 tregon që Leku u vlerësua kundrejt monedhës evropiane prej rreth 1.24 përqind dhe pësoi një zhvlerësim të konsiderueshëm kundrejt dollarit amerikan, me rreth 16.66 përqind krahasuar me periudhën janar – nëntor të një viti më parë duke reflektuar ecurinë e kësaj monedhe në bursat ndërkombëtare. Për periudhën janar – nëntor një Euro u ble mesatarisht me 122.77 lekë dhe një dollar u ble mesatarisht me 83.61 lekë. dhe kundrejt dollarit amerikan duke reflektuar në këtë mënyrë dhe ecurinë e tyre

B.1.3 Sektori i Jashtëm:

47. Gjatë periudhës janar - shtator të vitit 2008, u eksportuan rreth 86.7 miliard lekë (707.5 milion euro) mallra nga 73.2 miliardë lekë (589.5 milion euro) një vit më parë, duke rezultuar me një rritje vjetore prej 18.4 përqind. Kontributin më të lartë në këtë rritje e kanë dhënë eksporti i mineraleve, materialeve të ndërtimit e metaleve me rreth 15 pikë përqindje, si dhe eksporti i tekstileve e veshjeve të këmbëve me rreth 2 pikë përqindje.
48. Në të njëjtën kohë, u importuan rreth 295 miliard lekë (2.4 miliard euro) mallra nga 255.9 miliardë lekë (2 miliard euro) në të njëjtën periudhë të vitit 2007, duke shënuar një rritje prej rreth 15.3 përqind. Rritja e importit të produkteve ushqimore, pijeve e duhanit kontribuon në rritjen totale të importeve me rreth 3.7 pikë përqindje, ndërsa rreth 4.8 pikë përqindje ka ardhur prej shtimit të importeve të karburanteve. Një pjesë e mirë e rritjes së vlerës së importeve për këto grupe mallrash i atribuohet rritjes së çmimit të tyre në tregjet e huaja gjatë gjysmës së parë të vitit. Duhet theksuar që një tjetër faktor i rëndësishëm që ka nxitur rritjen e importeve gjatë kësaj periudhe, ka qenë zhvillimi i vrullshëm i biznesit, i cili në zgjerim të prodhimit të tij ka rritur kërkesën për mallra kapitale (investime) e mallra për konsum ndërmjetës. Kjo mbështetet nga fakti që një kontribut të konsiderueshëm në rritjen e importeve e kanë dhënë rritja në importet e makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit me 3.2 pikë përqindje dhe ajo e materialeve të ndërtimit e metaleve me rreth 1.1 pikë përqindje.
49. Të ardhurat nga shërbimet u rritën me 7.9 përqind në terma vjetorë, ndërsa shpenzimet për shërbime u rritën me 8.6 përqind. Shërbimet e udhëtimit kanë zënë peshën kryesore si në të ardhurat ashtu dhe në shpenzimet për shërbime, duke kontribuar përkatësisht me 78 përqind dhe 72 përqind në vlerën e përgjithshme të shërbimeve. Politikat favorizuese për turizmin kanë ndihmuar që ky i fundit të jetë një prej promotorëve kryesorë të zhvillimeve pozitive në të ardhurat nga shërbimet. Të ardhurat nga faktorët e prodhimit vazhdojnë të kenë një bilanc pozitiv e në rritje. Për nëntë – muajin e vitit 2008 bilanci i tyre rezultoi rreth 1.4 përqind më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Kjo rritje i atribuohet në një masë të konsiderueshme të ardhurave nga investimet e mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit.
50. Tashmë është në një tipar tradicional i ekonomisë shqiptare që dërgesat e emigrantëve të përbëjnë pjesën dërrmuese të transfertave korrente e të financojnë rreth gjysmën e deficitit tregtar të saj. Dërgesat e emigrantëve gjatë kësaj periudhe të vitit vlerësohen në rreth 623 milion euro. Megjithë një rënie krahasuar me një vit më parë, këto dërgesa vazhdojnë të mbulojnë rreth 37% të deficitit të tregtisë së mallrave.
51. Bilanci i llogarisë kapitale e financiare për këtë periudhë rezultoi me një suficit prej rreth 767.4 milion euro ose rreth 19.7 përqind më i lartë se një vit më parë. Fluksi neto i investimeve të huaja direkte ka rezultuar

⁸ Të dhënat për importet dhe eksportet janë në f.o.b (free on board) nga bilanci i pagesave – BSH.

sërisht me një rritje ndaj një viti më parë, vit i cili pati zhvillime mjaft të vrullshme në IHD, me një rritje rreth 80 përqind të tyre. Megjithatë kontribuesi kryesor në rritjen e bilancit të llogarisë financiare janë “kapitalet e tjera”, ku një pjesë e mirë i atribuohet rritjes së depozitave të jo-rezidentëve në sistemin tonë bankar, shprehje kjo e rritjes së interesit për të investuar në Shqipëri, si dhe borxhit të huaj të qeverisë të marrë për financimin e projekteve publike madhore. Nga ana tjetër huamarrja e jashtme e ekonomisë shqiptare është përqëndruar vetëm në kreditë afatgjatë dhe ato të buta. Gjithashtu shërbimi i borxhit të jashtëm është rreth 68 milion euro, i barazvlefshëm me 9.7% të eksporteve të mallrave.

52. Të gjitha këto zhvillime në llogarinë korrente e atë kapitale e financiare rezultuan në një bilanc të pagesave pozitiv prej rreth 101.4 milion euro. Rrjedhimisht shtesa e Rezervave Valutore të Autoritetit Monetar prej rreth 101.4 milion euro çoi totalin e rezervave valutore në rreth 1.6 miliard euro, i mjaftueshëm për të financuar rreth 4 muaj importe mallrash e shërbimesh.

B.2 Parashikimet Makroekonomike dhe Fiskale 2009-2011

B.2.1 Parashikimet Makroekonomike:

53. Shqipëria, një prej pak vendeve të cilat kanë patur një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme prej rreth 6 përqind për më tepër se 5 vjet, është duke kaluar një “momentum” pozitiv ekonomik. Kjo konfirmohet më së tepërmi me performancën e ekonomisë gjatë këtij viti, ku me gjithë problemet në energjinë elektrike, rritja ekonomike pritet të jetë të paktën 6 përqind.
54. Krahas progresit teknologjik e reformimit strukturor të ekonomisë, implementimi gjatë këtij dyvjecari i një serë politikash e rreformash efikase makroekonomike, të orientuara qartë nga “filozofia” e stimulimit të rritjes ekonomike nëpërmjet nxitjes së ofertës aggregate, i kanë dhënë një shtysë mjaft të fortë ekonomisë. Ndjekja e politikave makroekonomike të mirë-planifikuara e mirë koordinuara dhe thellimi i mëtejshëm i reformave ekonomike, krahas progresit teknologjik, akumulimit të kapitalit e ristrukturimit të ekonomisë drejt një ekonomie gjithnjë e më eficiente, do të sigurojnë që kjo ecuri ekonomike të vazhdojë e tillë edhe në të ardhmen afatmesme. Norma e parashikuar e rritjes reale ekonomike për katër vitet e ardhshme vlerësohet të jetë në nivelet mbi 6 përqind duke arritur 7 përqind në vitin 2010.
55. Disa nga faktorët dhe politikat kyçe të qeverisë që do të mbështesin perspektivën e rritjes ekonomike e zhvillimit social në një ambient makroekonomik të qëndrueshëm gjatë periudhës afatmesme 2008-2011 do të jenë:
- Besimi i biznesit po rritet vazhdimisht si rezultat i stabilitetit makroekonomik dhe i progresit drejt integritit në Bashkimin Europian. Qeveria po bën hapa përpara në heqjen e barrierave institucionale, në sistemin rregullator të biznesit dhe në atë fiskal, ç’ka bën të mundur rritjen e investimeve dhe zhvillimin e sektorëve ekonomikë kyç.
 - Vijimesia e konsolidimit fiskal, forcimi i mëtejshëm i administrimit dhe menaxhimit të të ardhurave, rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike, zgjatja e afatit të maturimit e reduktimi i nivelit të borxhit të brendshëm, adresimi i financimit të huaj kryesisht në financimin e shpenzimeve kapitale, përmirësimi në balancet korrente dhe primare, marrja e masave rregullative të tregut dhe përdorimi i incentivave fiskale që sigurojnë mbështetjen e investimeve publike dhe private .
 - Investimet publike janë rritur në vitet e fundit, dhe do të vazhdojnë të ndjekin një trend rritës në vitet e ardhshme, duke ndikuar sidomos në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, shërbimeve, arsim dhe shëndetësi, si edhe të furnizimit me energji elektrike. Edhe investimet private kanë arritur nivele të larta vitet e fundit, duke u përqëndruar në ndërtim, kryesisht për procesin e prodhimit, sektorin e shërbimeve dhe për banim.
 - Rritja e vazhdueshme e investimeve të brendshme e të huaja private, të nxitura prej politikave lehtësuese fiskale e monetare, pakësimit të barrierave administrative e prej një ambienti të qëndrueshëm makroekonomik.
 - Rritja e investimeve për makineri, pajisje, trainime, si edhe politikat mbështetëse fiskale për nxitjen e investimeve dhe zhvillimin teknologjik do të rrisin produktivitetin e fuqisë punëtore.
 - Ndjekja e një politike monetare të kujdesshme, mbajtja e inflacionit brenda intervalit 2-4 përqind, koordinim edhe më efikas i politikës fiskale e monetare, dhe ruajtja e stabilitetit financiar.

- Rritja e kapaciteteve prodhuese dhe konkurruese të ekonomisë shqiptare bazuar në; zbatimin e një sërë politikash mbështetëse për sektorë të ndryshëm, siç është ai i bujqësisë dhe energjisë; shfrytëzimin gjithnjë e më tepër të avantazheve krahasuese në përputhje me kapacitetet potenciale që ofron ekonomia vendase, do të rrisë gradualisht volumin e eksporteve dhe do të pakësoj në mënyrë konstante rritjen e importeve si rezultat i liberalizmit tregtar.
 - Privatizimi i sektoreve strategjike, si ai i shpërndarjes së energjisë elektrike, telekomunikacionit, nxjerrjes dhe përpunimit të naftës etj, do të ndihmojnë përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjes së efikasitetit prodhues.
 - Rritja, përmirësimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit financiar, bankar dhe jo-bankar, bazuar në: një sistemin financiar shqiptar me likuiditet të mjaftueshëm dhe të disponueshëm për biznesin; përmirësimin e aksesit në të drejtat e pronësisë; përmirësimin e marrëdhënieve të institucioneve financiare me një gamë më të gjërë klientësh që çon në një rritje të transaksioneve; rritjen e shpejtë e nivelit të kreditimit privat, nga sektori bankar ashtu edhe nga institucionet financiare jo-bankare, si ato mikrofinanciare, shoqëritë e kursim-kredisë, apo futja e shërbimeve të lizingut, për të arritur nivelet e standarteve ndërkombëtare.
 - Rritja e masave të mbikëqyrjes së cilësisë së huadhenies nga sistemi bankar dhe jo-bankar dhe vazhdimi i procesit të rritjes së shkallës së ndërmjetesimit financiar nëpërmjet: (i) përmirësimit të cilësisë së sistemit të pagesave; (ii) mbajtjes së normave reale pozitive të interesit; (iii) përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredive nga tregu bankar dhe jo-bankar; dhe (iv) rritjes së shkallës së qarkullimit të mjeteve monetare nëpërmjet sistemit bankar.
 - Ruajtja e pozicionit të qëndrueshëm të bilancit të pagesave, e shprehur në: (i) mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të rezervave valutore, (ii) reduktim të deficitit të llogarisë korente, (iii) rritje të investimeve të huaja direkte dhe hyrjeve neto kapitale.
56. Supozimet dhe prognozatat e disa treguesve dhe variablave kryesore që shërbejnë për parashikimin e PBB duke respektuar konsistencën midis tyre dhe marrëdhëniet midis sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, shprehen si më poshtë:
- Kursimet e brendshme parashikohen të arrijnë në 23.5 përqind të GDP-së në vitin 2011 nga 20.3 % në vitin 2008.
 - Rritja e raportit të investimeve totale ndaj GDP-së nga 26.9 % në vitin 2008 në 28.8 % në vitin 2011.
 - Në kushtet e pritshmërive për rënie të parasë jashtë bankave, rritje të depozitave si dhe ruajtjes së prirjes së kërkesës së brendshme për fonde hua, tendenca rritëse e kredisë për sektorin privat ndaj GDP-së pritet të arrijë në 48.4 % në vitin 2011 nga 34.1 % në vitin 2008
 - Oferta monetare prognozohet që të rritet gradualisht në 92.4 përqind të GDP-së në vitin 2011 nga 83.3 përqind që ajo parashikohet në vitin 2008 si rezultat rritjes së nivelit të depozitave si në lekë ashtu dhe në valutë (rritja më e lartë pritet të jetë në depozitat në monedhë vendase për të shënuar nivelin 44.2 përqind në vitin 2011 nga 37.4 përqind në vitin 2008).
 - Norma e rritjes së eksporteve pritet të jetë më e lartë se ajo e importeve. Si pasojë e thellimit të reformave të brendshme strukturore, vazhdimin të procesit të integritimit në BE e shfrytëzimit gjithnjë e më tepër të avantazheve krahasuese të ekonomisë tonë do të bëjnë që deficitin e bilancit tregtar të reduktohet gradualisht në 19.6 përqind të PBB në vitin 2011 nga 22.3 i parashikuar në vitin 2008.
 - Të ardhurat nga emigrantet për periudhën 2008-2011 janë parashikuar të rriten në të njëjtën linjë me normën vjetore të rritjes së transfertave private. (rreth 7 përqind në vit)
 - Investimet huaja direkte në raport me GDP-në parashikohet që të rriten gradualisht gjatë periudhës 2008-2011 për të arritur në 5.6 përqind të GDP-së në vitin 2011 nga 4.9 përqind në vitin 2008.
 - Kursi mesatar i këmbimit me euron parashikohet që të jetë i qëndrueshëm për periudhën e prognozuar në nivelin 122 lekë/euro kryesisht në sajë të faktorëve të përmendur më sipër si dhe mekanizmave të tjerë balancues të tregut të brendshëm e të jashtëm ashtu sikurse edhe nëpërmjet ndërhyrjeve të BSH-së në tregun valutë.
 - Deflatorët e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe asaj në total pritet të ruajnë tendencën historike duke marrë në konsideratë procesin ristrukturues të ekonomisë.
57. Faktorët, politikat dhe supozimet e sipërmendura pritet që të mbështesin parashikimet për një normë rritjeje mesatare mbi 6 përqind gjatë periudhës së prognozuar për të arritur në 7 përqind në vitin 2011. Mbi këtë bazë parashikimet të PBB-së për periudhën 2008-2011 dhe disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë paraqiten në tabelën e mëposhtme

Tabela 2. Treguesit kryesorë makroekonomike


Treguesit	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Popullsia	3,149,147	3,162,030	3,173,825	3,184,697	3,194,538	3,205,894
PBB nominal (në milion lekë)	892,000	979,000	1,073,000	1,178,000	1,291,000	1,419,000
PBB real (në milion lekë)*	862,330	945,520	1,037,740	1,142,745	1,259,282	1,381,370
Rritja nominale e PBB (në %)	9.1	9.8	9.6	9.8	9.6	9.9
Rritja reale e PBB (në %)	5.5	6.0	6.0	6.5	7.0	7.0
PBB nominal për banorë (në lekë)	283,251	309,611	338,078	369,894	404,127	442,622
PBB nominal për banorë (në usd)	2,887	3,402	3,675	4,021	4,393	4,811
Rritja nominale e PBB për banorë (në %)	8.6	9.3	9.2	9.4	9.3	9.5
Deflatori i GDP-se	3.4	3.5	3.4	3.1	2.5	2.7
Inflacioni mesatar vjetor	2.4	2.9	3.0	3.0	3.0	3.0
Kursi i këmbimit valutor (lekë/usd)	98.1	91.0	92.0	92.0	92.0	92.0
Kursi i këmbimit valutor (lekë/euro)	123	123.9	122	122	122	122
Investimet totale (në % të PBB)	25	25.7	26.9	27.8	28.7	28.8
nga të cilat publike	5.7	7.1	9.8	6.4	6.4	6.3
Kredia për sektorin privat (në % të PBB)	21.4	26.6	34.1	40	44.9	48.4
Oferta monetare (në % të PBB)	75.6	79.1	83.3	87.3	90.6	92.4
Bilanci tregtar (në % të PBB)	-23.2	-23.3	-22.3	-21.3	-20.4	-19.6
Bilanci i llogarisë korente (në % të PBB)	-7.4	-7.8	-6.5	-6.0	-5.5	-5.3
Bilanci i pagesave (në milion euro)	2.8	2.6	1.3	1.1	1.4	1.5

B.2.2 Parashikimi i Te Ardhurave:

58. Te ardhurat e buxhetit të shtetit për periudhën 2009-2011 janë parashikuar duke u bazuar në kuadrin makroekonomik të paraqitur më sipër. Gjatë kësaj periudhe trevjeçare parashikohet një rritje me ritme të qëndrueshme të të ardhurave në përqindje ndaj PPB, nga 27.1 % ndaj PPB në vitin 2009 (ose 319.4 miliard lek), 27.6% në vitin 2010 (ose 356 miliard leke) dhe 27.8% ndaj PPB në vitin 2011 (ose 394,4 miliard leke) krahasuar me 26.4% e PPB në vitin 2008, (283,6miliard lek) ose me 27% PPB së buxhetit të vitit 2007.
59. Kjo rritje graduale, por e qëndrueshme, e të ardhurave totale ndaj PPB vjen si rezultat i efekteve pozitive që parashikohen të merren nga reduktimet e konsiderueshme të normave të tarifave, që janë aplikuar gjatë 2 viteve të fundit, si dhe së fundi me ndryshimet thelbësore fiskale që u bënë në paketën fiskale të korrik 2007, me aplikimin e taksës së sheshtë. Parashikohet që këto reforma në vitet në vijim të japin efektet e tyre pozitive në buxhetin e të ardhurave totale, si në grafikun e mëposhtem:

Parashikimi i të ardhurave, për periudhën 2009-2011


(në milion lekë)



60. Gjithashtu, bazuar në parashikimet për periudhën 2009-2011 pritet një rritje e rëndësishme e të ardhurave nga kontributet nga në 4.8% ndaj PPB në vitin 2008 në 5.1% e PPB në vitin 2009, dhe me 5.3% të PPB në vazhdim.
61. Ndër elementët kryesorë të politikës së taksave për periudhën 2009-2011, mund të përmenden:
- Mbatja kostante të normës së TVSH-së gjatë (subjekt rishikimi në përputhje me programin e qeverisë)
 - Efektet që priten nga zbatimi i politikës së taksës së sheshtë për tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimin
 - Rishikimi i taksave nacionale në nivelet e tyre dhe në kuadër të reformës së decentralizimit fiskal
 - Rishikimi i nivelit të akcizës së mallrave të forta
 - Ulja e të ardhurave nga taksa doganore si rezultat i zbatimit të angazhimeve tarofores në Marrëveshjen e Ndërmjetme BE-Shqipëri, CEFTA, MTL me Turqinë
 - Norma e kontributit për sigurime shoqërore është parashikuar të mbetet e njëjta me nivelin e aplikuar në shtator të vitit 2006, si pasojë e rishikimit të skemës ekzistuese dhe rishikimi i politikës dhe masave së përmirësimit të kontributeve shoqërore dhe rishikimit të reformës së pensioneve
62. Për më tepër, këto politika fiskale do të shoqërohen me përmirësime të ndjeshme administrative në mbledhjen e këtyre taksave, sidomos në përmirësimet administrative tatimore, të cilat do të konsistojnë në riorganizimin e sistemit të administratës, rritjen e indikatorëve të performancës në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj taksapaguesit, futjen gjithësisht të praktikës e-files, aplikimin e reformave të nevojshme në shmangien e kontakteve inspektor tatimor-tatimpagues. Këto reforma administrative priten të japin efekte pozitive në uljen e evazionit fiskal. Për këtë arsye, gjatë parashikimit të të ardhurave, përveç indekseve makroekonomike është parashikuar pothuajse çdo zë të të ardhurave nga tatimet dhe doganat ndikimi i faktorit të përmirësimeve administrative dhe efekti i ndryshimit të politikave.
63. Parashikimi i të ardhurave nga tatimet dhe doganat si zëri kryesor i të ardhurave të buxhetit të shtetit, për periudhën 2009-2011 do të karakterizohet nga një rritje me ritme të kënaqshme, nga 18.5 % e PPB në vitin 2009 në 18.9% e PPB në vitin 2011, ose nga 217,930 miliard lekë në vitin 2009 në 268,1 miliard lekë në vitin 2011. Zërat kryesorë kontribues do të jenë të ardhurat nga TVSH dhe të ardhurat nga akciza, si dhe tregohet në grafikun e mëposhtem:

*Parashikimi i të ardhurave nga tatimet dhe doganat, sipas zërave.
Periudha 2008-2011*

(në milion lekë)



64. Parashikimi i të ardhurave në mënyrë të detajuar dhe faktorët e konsideruar në këto parashikime janë përsa më poshtë vijon.

Te ardhurat nga TVSH

65. Të ardhurat nga TVSH parashikohen të rriten me ritme të kënaqshme, duke u rritur dukshëm kontributi i tyre në përqindje ndaj PPB, nga 9.7% të PPB në vitin 2009, duke arritur në 9.9% të PPB në vitin 2011, ose nga 113.9 miliard lekë në vitin 2009 në 139.1 miliard lekë në vitin 2011.

66. Parashikimi i te ardhurave nga TVSH eshte bazuar ne:

- Mbajtjen konstante të normës së TVSH gjatë tre viteve (20 %)
- Trendin historik te këtyre të ardhurave
- Aspektet makroekonomike: rritjen ekonomike prej 6.5% në vitin 2009, 7% në vitin 2010 dhe 7% ne vitin 2011, si dhe nje norme konstante inflacioni përgjate periudhës, prej 3%.
- Përmirësimet administrative prej 4.5% në vitin 2009, 2.7% në vitin 2010 dhe 2.7% në vitin 2011

67. Bazuar ne keta tregues, baza e tatueshme e TVSH do të rritet me rritjen e vleres nominale te PBB dhe si rezultat i permiresimeve administrative dhe permiresimit te struktures se PBB-se ne dobi te sektoreve qe paguajne TVSH.

Te ardhurat nga Tatimi mbi fitimin

68. Siç dihet, për vitin 2008 është parashikuar një nivel i ulët i të ardhurave nga tatimi mbi fitimin, në rreth 14,4 miliard lekë, nga 22,9 miliard lekë që ishte në vitin 2007, si rezultat i përgjysmimit të normës së tatimit mbi fitim nga 20% në 10% që fillon të aplikohet në 1 janar 2008. Në vitin 2011 niveli i këtyre të ardhurave parashikohet të jetë rreth 20.6 miliard lekë, duke i rritur gradualisht ose 43% më shumë se parashikimi i 2008.

69. Ky parashikim i te ardhurave nga tatimi mbi fitimin për periudhën në vijim është bazuar ne:

- *Trendin historik*
- *rritjen e bazes tatimore (fitimi total i biznesit) si pasoje e rritjes ekonomike prej 6.5% në vitin 2009, 7% në vitin 2010 dhe 7% ne vitin 2011, si dhe nje norme konstante inflacioni përgjate periudhës, prej 3%*
- *Permiresimet administrative e strukture (rritja e PPB orientohet nga sektoret që paguajnë tatim fitimi). Për vitin 2009 parashikohet që ky faktor të jetë negativ (- 11%) si rrjedhoje e reduktimit drastik të përgjysmimit të normës së tatim fitimit, por në vitet 2010 dhe 2011 do te vijojne efektet pozitive te kësaj uljeje dhe konkretisht, ky faktor do te jetë rreth 1.3% në vitin 2010 dhe 2.6% në vitin 2011.*

Te ardhurat nga akciza

70. Parashikohet rritja e peshës së akcizës ndaj PPB duke arritur në 3.9% të PPB në vitin 2011 nga 3.6% e PPB në vitin 2008. Parashikimi i te ardhurave nga akciza është mbështetur në supozimet:

- Trendi historik i realizimit të këtyre të ardhurave
- Aspektet makroekonomike: rritjen ekonomike prej 6.5% në vitin 2009, 7% në vitin 2010 dhe 7% në vitin 2011, si dhe një normë konstante inflacioni përgjate periudhës, prej 3%
- Përmirësimet administrative dhe ndryshimi i normave të akcizës parashikohen të jenë rreth 6.6% në vitin 2009, 3.8% në vitin 2010 dhe 4% në vitin 2011.

71. Gjithashtu shkalla tatimore e akcizave për tre vitet në vazhdim parashikohet të harmonizohet sipas produkteve dhe niveleve të tyre të prodhimit vjetor sipas standarteve të Bashkimit Evropian.

Tatimi mbi te ardhurat personale

72. Për tatimin mbi te ardhurat personale parashikohet që gjatë tre viteve të ardhshme të kemi një rritje të vazhdueshme të bazës tatimore, duke pasur të pandryshuar normën e tatimit mbi te ardhurat personale, e cila ndryshoi në korrik 2007 me aplikimin e taksës së sheshtë prej 10%. Parashikimi i te ardhurave nga tatimi mbi te ardhurat personale do të ruajë trendin historik dhe kryesisht do të bazohet në përmirësimet administrative. Për vet natyrën e kësaj takse, parashikohet:

- Një rritje konstante e të ardhurave nga tatimi mbi te ardhurat personale, me një përqindje konstante rreth 1.6% e PPB për të tre vitet 2009-2011, krahasuar me 1.3% të PPB në vitin 2007 dhe 1.5% të PPB në vitin 2008. Në shifra nominale rritja do të jetë nga 16.2 miliard lekë në vitin 2008 në rreth 23.3 miliard lekë në vitin 2011.
- Aspektet makroekonomike si: rritjen ekonomike prej 6.5% në vitin 2009, 7% në vitin 2010 dhe 7% në vitin 2011, si dhe një normë konstante inflacioni përgjate periudhës, prej 3%.
- Përmirësimet administrative dhe efekti i politikës së zbatimit të taksës së sheshtë janë parashikuar me rreth 4.7% në vitin 2009, 5.7% në vitin 2010 dhe 4.2% në vitin 2011.

Te ardhurat nga taksat nacionale dhe te tjera

73. Gjatë periudhës tre vjeçare, niveli i taksave nacionale do të jenë subjekt rishikim, dhe parashikimi i te ardhurave bazohet:

- Trendi historik i vjeljes së këtyre të ardhurave;
- Mbajtja e një niveli konstant inflacioni, prej 3%;
- të përmirësimeve administrative në mbledhjen e tyre si dhe të reformave që do të ndërmerren në kuadër të decentralizimit fiskal. Ky faktor është parashikuar rreth 8.8% në vitin 2009, 4.3% në vitin 2010 dhe 2.6% në vitin 2011.

74. Për këtë arsye, parashikohet një rritje e lehtë e nivelit të këtyre taksave, duke mbetur në normat 1.6%-1.7% të PPB gjatë periudhës 2009-2011, ose në 19 miliard lekë në 2009 në 21.6 miliard lekë në vitin 2010 dhe në 24 miliard lekë në vitin 2011 krahasuar me 17,2 miliard lekë në 2008.

Te ardhurat nga taksa doganore

75. Të ardhurat nga taksat doganore do të vazhdojnë trendin rënës të tyre edhe për periudhën 2009-2011, si rezultat i reduktimit të niveleve të tarifës doganore nga zbatimi i angazhimeve tarifore të ndërmarrura në Marrëveshjen e Ndërmjetme BE—Shqipëri, OBT, CEFTA, MTL me Turqinë. Reduktimet e këtyre tarifave me OBT do të jenë deri në 2009 dhe reduktimet thelbësore të MTL me BE, CEFTA dhe me Turqinë do të jenë më drastike gjatë 2008-2011.

76. Kështu, në vitin 2009 rreth 6.1 miliard lekë, në vitin 2010 rreth 5.6 miliard lekë, dhe në vitin 2011 rreth 6.2 miliard lekë krahasuar me 9.4 miliard lekë të parashikuar për vitin 2008.

⁹ Në vitin 2011 mbaron faza e reduktimeve graduale për produktet bujqësore dhe industriale të ndërmarrura në Marrëveshjen e Ndërmjetme me BE.

77. Megjithatë gjatë parashikimit të nivelit të të ardhurave doganore është marrë në konsideratë se efektet negative të reduktimit të tarifave do të kompensohen deri diku me rritjen e volumit të importeve nga këto vende si rezultat i efekteve pozitive që do të sjellin këto politika liberalizuese tarifore.

Te ardhurat nga Pushteti Vendor

78. Parashikimi i te ardhurave eshte bazuar ne:

- Trendin historik
- Aspektet makroekonomike: rritjen ekonomike prej 6.5% në vitin 2009, 7% në vitin 2010 dhe 7% ne vitin 2011, si dhe nje norme konstante inflacioni përgjate periudhës, prej 3%.
- Përmirësimet administrative dhe reformës që do të ndërmerret në kuadër të decentralizimit fiskal, për të ardhurat e qeverisjes vendore. Konkretisht, për të ardhurat nga biznesi i vogël ky faktor parashikohet të jetë rreth 8.2% në vitin 2009, 4.6% në vitin 2010 dhe rreth 4.6% në vitin 2011

Te ardhurat nga Kontributet per Sigurime Shoqerore e Shendetesore

79. Rritja e parashikuar e të ardhurave nga kontributet do të jetë rrjedhojë e rritjes ekonomike, formalizimit të tregut të punës ndërmjet përmirësimit të regjistrimit me anë të pajisjes me kartë identiteti, si edhe eliminimit gradual të raportit midis normës së kontributeve që paguan punëdhënësi dhe asaj që paguan punëmarrësi, për të arritur në nivelin e vendeve të tjera. Gjithashtu, këto të ardhura do të jenë subjekt ndryshimi për shkak të ndryshimit dhe reformimit të skemës ekzistuese të pensioneve.

80. Parashikimi i te ardhurave eshte bazuar ne:

- Trendin historik
- Aspektet makroekonomike: rritjen ekonomike prej 6.5% në vitin 2009, 7% në vitin 2010 dhe 7% ne vitin 2011, si dhe nje norme konstante inflacioni përgjate periudhës, prej 3%.
- Përmirësimet administrative dhe në mbledhjen e tyre. Konkretisht, për të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore ky faktor parashikohet të jetë rreth 7.8% në vitin 2009, 5.6% në vitin 2010 dhe 2.5% në vitin 2011

81. Gjithashtu, parashikimi i te ardhurave eshte bazuar ne rritjen e numrit te te punesuarve qe do te perfshihen ne sektorin formal, ashtu edhe ne uljen e evazionit si pasoje e deklarimit te sakte te nivelit te pages. Megjithate keto te ardhura do te jene subjekt ndryshimi per shkak te ndryshimit te skemes ekzistuese te pensioneve, që do të varte nga hartimi i strategjisë së reformimit të sistemit aktual dhe percaktimit të formes së sistemit shumëshytlles (normës së kontributeve, moshës dhe vitit të futjes së shtyllës së dyte), do të bëhet nga një grup teknik pune me pjesmarrjen e ekspertëve përfaqësues të qeverisë, partive politike opozitare si edhe organizatave joqeveritare.

Te ardhurat jotatimore

82. Parashikimi i të ardhurave jotatimore është bazuar në supozimin që transferimi i fitimit nga BSH do të jetë konstant. Të ardhurat nga institucionet buxhetore do të rriten, duke pasqyruar si rritjen e inflacionit, ashtu edhe rritjen e shërbimeve ndaj publikut, ndersa të ardhurat nga dividendi do të jenë përsëri objekt rishikimi për shkak të procesit të privatizimit të aksioneve të Qeverisë në ndërmarrjet publike.

Te ardhurat nga ndihmat dhe grantet

83. Parashikimi i të ardhurave nga ndihmat dhe grantet është bazuar në PBA 2008-2010, si dhe ne parashikimet e pritshme te granteve nga BE.

Te ardhurat nga privatizimi

84. Të ardhurat nga privatizimi janë parashikuar në nivele modeste, pasi nuk është përfshirë privatizimi i sektorëve strategjikë. Te ardhurat nga privatizimet strategjike do te behen pjese e buxhetit kur te realizohen dhe do perdoren per shpenzime kapitale dhe uljen e borxhit publik.

Huamarrja e brendshme

85. Niveli i huamarrjes së brendshme parashikohet te arrije ne rreth 2% te PBB-se, mbeshtetur ne objektivat per nje nivel te pergjithshem te deficitit buxhetor prej rreth 3%.

Huamarrja e Huaj

86. Niveli i huamarrjes së huaj është parashikuar në bazë të marreveshjeve dhe kontratave të lidhura me institucionet financiare ndërkombetare dhe qeverite të huaja si dhe atyre të parashikuara për të ardhmen.

B.4.2 Shperndarja e Shpenzimeve Buxhetore

87. Për periudhën 2009-2011, shpenzimet buxhetore parashikohen që të qendrojnë në intervalin 30%-32% të PBB-së. Në këtë vlerësim nuk përfshihet përdorimi i të ardhurave nga privatizimet strategjike, përdorimi i të cilave do të rezultonte në një nivel më të lartë të shpenzimeve totale dhe shpenzimeve kapitale.

Shpenzimet për personelin

88. Shpenzimet për personelin e administratës publike do të qendrojnë konstante në vitet në vijim në raport me PBB-në (6.3%), që do të thotë një indeksim i plotë me nivelin e inflacionit dhe rritje reale të diferencuar për sektore prioritarë, në përputhje me objektivat e reformës në administratën publike.

Shpenzimet për interesat

89. Parashikimi i shpenzimeve për interesat është bazuar në strategjinë e financave, e cila parashikon një ulje graduale për periudhën 2009-2011, si pasojë e uljes relative të borxhit publik gjatë kësaj periudhe.

Shpenzimet operative dhe të mirembajtjes

90. Shpenzimet operative dhe të mirembajtjes parashikohet të rriten në terma reale për tre vitet e ardhshme duke arritur në 3.1% të PBB në 2011. Kjo rritje do të orientohet kryesisht në shpenzimet e mirembajtjes, si rrjedhojë e rritjes së nivelit të investimeve gjatë këtyre viteve. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet operative të parashikuara për administratën do të vijne duke u ulur në raport me PBB-në, duke krijuar mundësi për rritje më të shpejtë të shpenzimeve për mirembajtjen në sektoret prioritarë si infrastrukture, arsim dhe shëndetësi, por edhe të shpenzimeve për politika specifike sektoriale siç janë ato të mbështetjes në bujqësi, nxitjes së eksporteve, mjedisit etj.

Shpenzimet për subvencione

91. Shpenzimet për subvencione janë parashikuar duke u bazuar në politikat ekzistuese të subvencioneve, si dhe në politiken buxhetore për pakësimin e tyre në vazhdimësi.

Shpenzimet për buxhetin lokal

92. Këto shpenzime do të vazhdojnë të rriten në terma reale përgjatë periudhës 2009-2011 duke arritur në 3% të PBB-së në vitin 2011. Burimi kryesor i rritjes është parashikuar të jetë rritja e të ardhurave lokale, që do të vijë si nga përmirësimi i administrimit, ashtu edhe nga politikat e reja fiskale.

Shpenzimet për transfertat

93. Shpenzimet për pagesë papunesie, ndihmë ekonomike dhe paaftesi, parashikohen të mbeten konstante në raport me PBB-në. Këtu do të mbahet parasysh politika për një rritje të diferencuar midis zerave përberës të këtyre shpenzimeve. Ndërsa ndihma ekonomike, si rezultat i përmirësimeve ligjore dhe administrative do të vijë duke u ulur (në terma relative) pjesë më e madhe e rritjes do të shkojë për pagesën e paaftesisë, si rezultat i indeksimit të saj dhe rritjes së numrit të përfituesve.

Shpenzimet kapitale

94. Shpenzimet kapitale për tre vitet e ardhshme parashikohen mesatarisht në nivelet mbi 6.3-6.4% të PBB-së, kjo në varesi edhe të nivelit dhe ecurisë së disbursimeve të financimeve të huaja. Pas ritmeve të larta të investimeve në vitet 2007, 2008, investimet do të stabilizohen në këto nivele gjatë 3 viteve të PBA 2009-2011, duke lejuar që një pjesë e mirë e alokimeve buxhetore të fillojë të kalojë tek mirembajtja. Investimet do të vazhdojnë të mbështesin sektoret prioritarë si arsim, shëndetësi dhe infrastrukture.

Tabela 5. Treguesit Fiskale te PBA 2009-2011 (ne milione leke)

TREGUESIT FISKALE TE PBA 2009-2011
(FISCAL INDICATORS FOR MTBP 2009-2011)

ne milion leke (in million of leks)

Nr.	E M E R T I M I	Akti Normativ 2008	Buxheti 2009	P/Buxheti 2010	P/Buxheti 2011	I T E M S
	TOTALI TE ARDHURAVE	298,220	334,823	373,301	411,792	TOTAL REVENUE
I.	Te ardhura nga ndihmat	2,507	6,313	6,490	7,145	Grants
	Nga kjo: Mbeshtetje buxhetore	0				From which: Budget Support
II.	Te ardhura tatimore	270,952	305,988	347,709	384,506	Tax Revenue
II.1.	Nga Tatimet dhe Doganat	209,711	230,168	249,517	277,022	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	106,903	117,491	130,416	145,090	V.A. T & Turnover Tax
2	Tatimi mbi Fitimin	18,420	20,813	23,353	26,019	Profit Tax
3	Akczizat	35,493	44,363	49,263	54,726	Excise Tax
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	23,272	26,065	28,084	30,980	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	16,212	15,312	12,801	13,984	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	9,411	6,124	5,600	6,222	Customs Duties
II.2.	Te ardhura nga Pushteti Vendor	13,082	18,412	29,398	31,747	Local Taxes
1	Taksa Lokale	7,987	11,114	21,125	22,625	Local Taxes
2	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	2,136	3,734	5,562	5,957	Property Tax
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	2,959	3,564	2,711	3,166	Small Business Tax
II.3.	Te ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	48,159	57,408	68,794	75,737	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqeror	42,936	51,029	61,502	67,709	Social Insurance
2	Sigurimi Shendetesor	5,223	6,379	7,292	8,028	Health insurance
III.	Te ardhura Jotimore	24,761	22,522	19,102	20,141	Nontax Revenue
1	Tran. Fitimi nga Banka e Shqiprise	5,500	5,700	5,800	5,900	Profit transfer from BOA
2	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	10,800	11,857	11,847	12,841	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	5,243	165	455	400	Divident
4	Te tjera	3218	1000	1000	1000	Other/not allocated
5	Te tjera nga ISSH		3,800			Other from ISSH
	TOTALI I SHPENZIMEVE	354,760	384,834	420,143	459,012	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	254,841	283,698	315,973	347,953	Current Expenditures
1	Personeli	67,060	59,651	80,865	89,027	Personnel expenditures
	Paga	56,451	51,563			Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	10,609	8,088			Social insurance contributions
	Politikat e reja pagash		0	4,338	9,222	Of which: Contingency for new policies
2	Interesat	31,575	36,040	38,481	41,100	Interest
	Te Brendshme	28,400	31,420	32,000	33,900	Domestic
	Te Huaja	3,175	4,620	6,481	7,200	Foreign
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	28,079	35,813	39,977	46,031	Operational & Maintenance
	Nga e cila: Financim i Huaj	225	0			From which: Foreign Financing
	Shpenzime per planifikim, menaxhim & administrim		3,524			From which: for administration
4	Subvencionet	2,566	2,022	2,868	2,900	Subsidies
5	Shpenzime per Sig. Shoq e Shendet	77,873	95,866	94,183	103,003	Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	66,713	71,655	80,525	87,830	Social insurance
	Sigurime Shendetesore	11,160	24,211	13,658	15,173	Health insurance
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	29,146	36,835	38,883	42,826	Local Budget expenditure
	Buxheti vendor (Granti)	16,064	18,423	9,485	11,079	Local Budget (Grant)
	Buxheti vendor (Te ardhurat e veta)	13,082	18,412	29,398	31,747	Local Budget (Own revenues)
7	Shpenzime te tjera	18,042	16,871	20,016	22,266	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	900	1,000	1,267	1,376	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike	14,742	13,871	15,249	17,389	Social assistance
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	1,000	2,000	2,000	2,000	Compensation for ex political prisoners
	Kompensim per energjine elektrike	1,400	0	1,500	1,500	Compensation for electricity
8	Kompensim ne vlere i pronareve	500	600	700	800	Property Compensation
II.	Fondi Rezerve, Kontigjenca	5,700	15,700	14,400	15,800	Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	2,400	2,000	2,500	2,500	CoM Reserve Fund
	Fondi Kontigjenca per Politika Pagash & Pensionesh	2,000	7,700	4,700	4,800	Contingency for Wages and Pensions Increase
	Fond Kontigjenca	1,300	6,000	7,200	8,500	Contingency for Deficit
III.	Gerdeci nga te ardhurat	480				
IV.	Shpenzime Kapitale	91,139	90,436	89,770	95,259	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	49,063	68,661	60,156	65,408	Domestic financing
	Nga e cila: Kontigjenca per inv. publike			6,000	6,000	Of which: Contingency
	Per investime Publike		5,000			Public Investment
	Per rrugen Rreshen- Kalimash		30,000			For the Rreshen - Kalimash Road
	Financimi Huaj	41,926	21,775	29,614	29,851	Foreign financing
V.	Net Lending	2,600	-5,000			
	DEFICITI	-56,424	-50,011	-46,842	-47,219	Cash balance
	FINANCIMI DEFICITIT	56,541	50,011	46,842	47,219	Financing (Cash)
	Brendshem	21,847	41,699	30,718	32,014	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi	2,000	200	1,000	500	Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	19,847	41,499	29,718	31,514	Domestic borrowing
	I Huaj	34,694	8,312	16,124	15,206	Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	39,644	15,462	23,124	22,706	Long-term Loan(Drawings)
	Ripagesat	-4,950	-7,150	-7,000	-7,500	Repayments
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	1,078,000	1,180,000	1,298,000	1,429,000	

Tabela 6. Treguesit Fiskale te PBA 2009-2011 (ne % te PBB)

TREGUESIT FISKALE TE PBA 2009-2011 (FISCAL INDICATORS FOR MTBF 2009-2011) ne % te PBB (in % of GDP)						
Nr.	E M E R T I M I	Akti Normativ 2008	Buxheti 2009	P/Buxheti 2010	P/Buxheti 2011	I T E M S
	TOTALI TE ARDHURAVE	27.7%	28.4%	28.8%	28.8%	TOTAL REVENUE
I.	Te ardhura nga ndihmat	0.2%	0.5%	0.5%	0.5%	Grants
	Nga kjo:Mbeshtetje buxhetore	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	From which: Budget Support
II.	Te ardhura tatimore	25.1%	25.9%	26.8%	26.9%	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	19.5%	19.5%	19.2%	19.4%	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	9.9%	10.0%	10.0%	10.2%	V.A. T & Turnover Tax
2	Tatimi mbi Fitimin	1.7%	1.8%	1.8%	1.8%	Profit Tax
3	Akcizat	3.3%	3.8%	3.8%	3.8%	Excise Tax
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	2.2%	2.2%	2.2%	2.2%	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1.5%	1.3%	1.0%	1.0%	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	0.9%	0.5%	0.4%	0.4%	Customs Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	1.2%	1.6%	2.3%	2.2%	Local Taxes
1	Taksa Lokale	0.7%	0.9%	1.6%	1.6%	Local Taxes
2	Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)	0.2%	0.3%	0.4%	0.4%	Property Tax
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	0.3%	0.3%	0.2%	0.2%	Small Business Tax
II.3	Te ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	4.5%	4.9%	5.3%	5.3%	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqeror	4.0%	4.3%	4.7%	4.7%	Social Insurance
2	Sigurimi Shendetesor	0.5%	0.5%	0.6%	0.6%	Health insurance
III.	Te ardhura Jotatimore	2.3%	1.9%	1.5%	1.4%	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0.5%	0.5%	0.4%	0.4%	Profit transfer from BOA
2	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	1.0%	1.0%	0.9%	0.9%	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	0.5%	0.0%	0.0%	0.0%	Divident
4	Te tjera	0.3%	0.1%	0.1%	0.1%	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32.9%	32.61%	32.37%	32.12%	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	23.6%	24.04%	24.34%	24.35%	Current Expenditures
1	Personeli	6.22%	5.06%	6.23%	6.23%	Personnel expenditures
	Paga	5.2%	4.37%	0.00%	0.00%	Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	1.0%	0.69%	0.00%	0.00%	Social insurance contributions
	Politikat e reja pagash	0.0%	0.00%	0.33%	0.65%	Of which: Contingency for new policies
2	Interesat	2.9%	3.05%	2.96%	2.88%	Interest
	Te Brendshme	2.6%	2.66%	2.47%	2.37%	Domestic
	Te Huaja	0.3%	0.39%	0.50%	0.50%	Foreign
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	2.6%	3.04%	3.08%	3.22%	Operational & Maintenance
	Nga e cila: Financimi i Huaj	0.0%	0.00%	0.00%	0.00%	From which: Foreign Financing
	Kontigjence	0.0%	0.30%	0.00%	0.00%	From which:Contingency
4	Subvencionet	0.2%	0.17%	0.22%	0.20%	Subsidies
5	Shpenzime per Sig.Shoq e Shendet	7.2%	8.12%	7.26%	7.21%	Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	6.2%	6.07%	6.20%	6.15%	Social insurance
	Sigurime Shendetesore	1.0%	2.05%	1.05%	1.06%	Health insurance
6	Shpenzime per Buxhetin Lokal	2.7%	3.12%	3.00%	3.00%	Local Budget expenditure
	Buxheti lokal (Granti)	1.5%	1.56%	0.73%	0.78%	Local Budget (Grant)
	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	1.2%	1.56%	2.26%	2.22%	Local Budget (Own revenues)
7	Shpenzime te tjera	1.7%	1.43%	1.54%	1.56%	Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	0.1%	0.08%	0.10%	0.10%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike dhe paaftesia	1.4%	1.18%	1.17%	1.22%	Social assistance
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	0.1%	0.17%	0.15%	0.14%	Compensation for ex political prisoners
	Kompensim per energjine elektrike	0.1%	0.00%	0.12%	0.10%	Compensation for electricity
8	Kompensim ne vlere i pronareve	0.0%	0.05%	0.05%	0.06%	Property Compensation
II.	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0.5%	1.33%	1.11%	1.11%	Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0.2%	0.17%	0.19%	0.17%	CoM Reserve Fund
	Fondi Kontigjence per Politika Pagash&Pensionesh	0.2%	0.65%	0.36%	0.34%	Contingency for Wages and Pensions
	Fond Kontigjence	0.1%	0.51%	0.55%	0.59%	Increase
	Fond Kontigjence	0.1%	0.51%	0.55%	0.59%	Contingency for Deficit
III.	Shpenzime Kapitale	8.5%	7.66%	6.92%	6.67%	Capital expenditures
	Financimi Brendshem	4.6%	5.82%	4.63%	4.58%	Domestic financing
	Nga e cila: Kontigjence per inv.publike	0.0%	0.00%	0.46%	0.42%	Of which: Contingency
	Per investime Publike	0.0%	0.42%	0.00%	0.00%	Competition Grant for Education (Loc. Gov.)
	Per rrugen Rreshen- Kalimash	0.0%	2.54%	0.00%	0.00%	Competition Grant for Health (Loc. Gov.)
	Financimi Huaj	3.9%	1.85%	2.28%	2.09%	Foreign financing
IV	Huadhenie neto KESH					Net Lending
	DEFICITI	-5.2%	-4.24%	-3.61%	-3.30%	Cash balance
	FINANCIMI DEFICITIT	5.2%	4.24%	3.61%	3.30%	Financing (Cash)
	Brendshem	2.0%	3.53%	2.37%	2.24%	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi	0.2%	0.02%	0.08%	0.03%	Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	1.8%	3.52%	2.29%	2.21%	Domestic borrowing
	I Huaj	3.2%	0.70%	1.24%	1.06%	Foreign
	Hua afatgjate (e marre)	3.7%	1.31%	1.78%	1.59%	Long-term Loan(Drawings)
	Ripagesat	-0.5%	-0.61%	-0.54%	-0.52%	Repayments
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	

C. Programet Buxhetore Afatmesme te Ministrive te Linjes

95. Kerkesat per shpenzime buxhetore te PBA 2009-2011 per te gjitha Ministrive te Linjes dhe Institucionet Qendrore te listuara me poshte jane sjelle duke mbajtur ne konsiderate Tavanet e miratuara nga KPS dhe te derguara nepermjet Udhezimit per Pergatitjen e Buxhetit Nr.11/1 date 10 Korrik 2008, si edhe ne perputhje me shperndarjen e tyre sipas struktures programore te cdo institucioni.

C.1 Ministria e Shendetesise

C.1.1 Misioni i Ministrise:

Ministria e Shendetesise harton dhe zbaton politikat e strategjite e zhvillimit ne sistemin shendetesor, eshte pergjegjese per rregullimin e tij, si dhe per koordinimin e te gjithe aktoreve brenda dhe jashte sistemit shendetesor.

C.1.2 Qellimet e Politikes:

96. Politika e ketij sektori eshte hartuar per te kontribuar ne arritjen e qellimeve te meposhtme afatgjata:


- Nje kuader ligjor i plote dhe modern,
- Sistem financimi adekuat
- Burime njerezore te afta per tu pergjigjur nevojave te sistemit shendetesor
- Nje sistem informacioni te plote ne te gjitha nivelet e sherbimit shendetesor.
- Vendosja e pacientit ne qender te sistemit dhe rritja e rolit te tij.
- Akses me i mire per KSHP
- Ofrimi i sherbimeve sipas normave dhe standardeve te percaktuara.
- 100% e territorit te vendit e mbuluar me ambulanca deri ne vitin 2015.
- Niveli i vdekshmerise se femijeve nen 5 vjeç i reduktuar ne 10/1000 lindje te gjalla deri ne 2015 ne krahasim me 20/1000 lindje te gjalla per vitin 2001.
- Vdekshmeria amtare ne vitin 2015 e reduktuar me 1/2 nga 2001 (22, 7 vdekje per 100 000 lindje te gjalla.
- 90% e popullsise e edukuar mbi principet e kujdesit shendetesor te gojes dhe 90% e grupmoshes 0-6 vjeç qe do te perfitoje nga fluorizimi deri ne vitin 2015.
- Plotesimi gjithnje ne rritje i nevojave te popullates per kujdes mjekesor te specializuar nepermjet funksionimit te strukturave spitalore sipas modeleve bashkekohore te manaxhimit spitalor deri ne vitin 2015.
- Kontrollin e semundjeve infektive nepermjet :
- Forcimit te programit te imunizimit duke siguruar me vaksinat 100% sipas kalendarit te vaksinimit dhe mbulesen vaksinale te tyre mbi 90%.
- Forcimit te survejances epidemiologjike.
- Monitorimit te ujit te pijshem.
- Kontrollin e semundjeve jo infektive,
- Vleresimi i faktoreve te riskut,
- Nxitja e procesit te depistimit dhe promovimi nje jete te shendetshme.
- Ne bashkepunim me ministrine e Mjedisit, zgjerimi dhe forcimi i monitorimit te agjenteve mjedisor (ajri, zhurmat dhe ujrart siperfaqesore)
- Labororet e shendetit publik te fuqizuar totalisht deri ne vitin 2015

C.1.3 Programet e Shpenzimeve te Ministrise


97. Ministria e Shendetesise ka 4 programe:

- Planifikim, Menaxhim, Administrim
- Sherbimet e Kujdesit Paresor
- Sherbimet e Kujdesit Dytesor
- Shendetit Publik

Shpenzimet buxhetore te Ministrise se Shendetesise ne nivel programi per periudhen e PBA, jepen ne grafikun e meposhtem:



Ndersa, shpenzimet buxhetore te po ketij institucioni, ne nivel ministrie, per periudhen e PBA, jepen ne grafikun e meposhtem:



01110 Planifikim Menaxhim Administrim

98. **Politika e ketij Programi** konsiston ne funksione te formulimit te politikave e strategjive per te gjitha sherbimet shendetesore, licensimin, akreditimin, monitorimin, inspektimin, hartimin e permiresimin e kuadrit ligjor dhe standarteve te sherbimeve te kujdesit shendetesor, ngritjen e permiresimin e kapaciteteve planifikuese, menaxhuese etj.

99. **Objektivat e politikës per vitin 2009:**

- Monitorimi i aktiviteve te DSHP-ve te qarqeve bazuar ne standartet shendetesore.
- 5% te tjere te stafit shendetesor te trajnuar nga qendra e formimit te vazhdueshem profesional;
- Planifikim dhe kategorizim i burimeve njerezore ne shkalle kombetare per sektorin e shendetesise i ngritur;
- Pilotimi i standarteve, mbikqyrjes dhe procedurave akredituese ne tre spitale;
- Zbatimi i planit afat mesem te perafimit te legjislacionit

100. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- 12 dokumente te prodhuar per manaxhimin e politikës sektoriale.

- Pagesa e Kosos Lokale per 1 projekt. Kosto per njesi: 3 milion leke.
- 2 Projektme ndertimi per MSH. Kosto per njesi: 1.25 milione leke.
- 10 % e nevojave me pajisje mobilimi dhe zyre
- 100 % e nevojave te plotesuara me ambiente te rikonstruara

101. **Objektivat e politikave per vitin 2010:**

- Monitorimi i aktiviteteve te DSHP-ve te qarqeve bazuar ne standartet shendetesore;
- 5% te tjere te stafit shendetesor te trajnuar nga qendra e formimit te vazhdueshem profesional;
- Planifikim dhe kategorizim i burimeve njerezore ne shkalle kombetare per sektorin e shendetesise i ngritur;
- Pilotimi i standarteve, mbikqyrjes dhe procedurave akredituese ne tre spitale;
- Zbatimi i planit afat mesem te perafimit te legjislacionit.

102. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:**

- Manaxhimi i politikave sektoriale
- Pagesa e Kosos Lokale per 1 projekt; kosto per njesi: 5 milion leke.
- 2 Projektme ndertimi per MSH, kosto per njesi 5 milione leke.
- 20 % e nevojave te plotesuara me pajisje mobilimi dhe zyre; kosto per njesi 1.7 milione leke

103. **Objektivat e politikave per vitin 2011:**

- Monitorimi i aktiviteteve te DSHP-ve te qarqeve bazuar ne standartet shendetesore;
- 5% te tjere te stafit shendetesor te trajnuar nga qendra e formimit te vazhdueshem profesional;
- Planifikim dhe kategorizim i burimeve njerezore ne shkalle kombetare per sektorin e shendetesise i ngritur;
- Pilotimi i standarteve, mbikqyrjes dhe procedurave akredituese ne tre spitale;
- Zbatimi i planit afat mesem te perafimit te legjislacionit.

104. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2011:**

- Manaxhimi i politikave sektoriale
- Pagesa e Kosos Lokale per 1 projekt. Kosto per njesi: 5 milion leke.
- 2 Projektme ndertimi per MSH. Kosto per njesi 7 milione leke.
- 10 % e nevojave te plotesuara me pajisje mobilimi dhe zyre. Kosto per njesi 5.5 milione leke.

105. **Standartet e Politikave:**

- Personat qe punojne ne departamentet e planifikimit ne DSHP te jene te diplomuar ne ekonomi.
- Cdo drejtues institucioni duhet te kete kualifikime pas universitare ne fushen e manaxhimit shendetesor.

07220 Sherbimet e Kujdesit Paresor

106. **Politika e ketij Programi** konsiston ne ofrimin e sherbimeve cilesore te kujdesit shendetesor paresor te bazuar ne komponentet e kujdesit kurativ, parandalues dhe promociional. Dhenia e autonomise se sherbimit te kujdesit shendetesor paresor. Hartimi i standarteve dhe normativave per KSHP.

107. **Objektivat e politikave per vitin 2009:**

- 10% e fshatrave e mbuluar me ambulanca çdo vit;
- 10% e totalit te infrastruktures te sherbimit stomatologjik publik e permiresuar dhe 10% e popullsisë e mbuluar me sherbim parandalues çdo vit;
- 10% e QSH e plotesuar me pajisje zyre çdo vit;
- Rritje ne masen 10% e kontributit te buxhetit te shtetit per sigurimin e kontraceptiveve ne sherbimet publike te planifikimit familjar;
- Sistemi i informacionit ne KSHP per 6 qarqe i perfunduar;
- Trajnimi i mjekut te familjes ne 5 qarqe.

108. **Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:**

- 270.000 Femije deri ne 18 vjec te trajtuar ne sherbimin stomatologjik. Kosto per njesi 1.1 mije leke.
- Funksionimi i 36 strukturave te KSHP ne varesi te MS
- 6 % e nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore
- 2 Projekte te mbeshtetura me kontributin e TVSH & detyrimi doganor
- 5 Poliklinika te rehabilituara; kosto per njesi 120 milione leke
- 6 % e nevojave te plotesuara me pajisje mobilimi dhe zyre
- 2% e nevojave te plotesuara me ambjente te rikonstruata
- 4.700.000 vizita te kryera ne njesite e kujdesit shendetesor paresor; kosto per njesi 1.3 mije leke
- 375 medikamente te rimbursueshme; kosto per njesi 11.7 milione leke
- 13.000 paciente te trajtuar ne spitalin e Durresit; kosto per njesi 51.5 mije leke
- Funksionimi i ISKSH
- 10 % e nevojave te plotesuara te investime
- 8500 paciente te trajtuar me ekzaminime te shtrenjta; 16.5 mije leke
- 5% e nevojave te plotesuara me ambjente te rikonstruata

109. **Objektivat e politikës për vitin 2010:**

- 10% e fshatrave e mbuluar me ambulanca çdo vit;
- 10% e totalit të infrastruktures të shërbimit stomatologjik publik e përmirësuar dhe 10% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit;
- 10% e QSH e plotësuar me pajisje zyre çdo vit;
- Rritje në masën 10% e kontributit të buxhetit të shtetit për sigurimin e kontrceptiveve në shërbimet publike të planifikimit familjar;
- Sistemi i informacionit në KSHP për 11 qarqe të konsoliduar;
- Sistemi i informacionit në KSHP në Tiranë të përfunduar;
- Trajnimi i mjekut të familjes në 2 qarqe të tjera.

110. **Produktet kryesore që do të ofrohen në 2010**

- 280.000 deri në 18 vjet të trajtuar në shërbimin stomatologjik. Kosto për njësi 1.4 mije leke.
- Funksionimi i 36 strukturave të KSHP në varesi të MSH
- 8% e nevojave të plotësuar me pajisje mjekesore
- 2% e nevojave të plotësuar me ambjente të rikonstruata në QSH
- 2 projekte të mbështetura me kontributin e TVSH & detyrimi doganor
- 5 Poliklinika të rehabilituara, kosto për njësi 40 milione leke
- 6% e nevojave të plotësuar me pajisje mobilimi dhe zyre
- 5.200.000 vizita të kryera në njesitë e kujdesit shëndetësor paresor, kosto për njësi 1.38 mije leke
- 375 medikamente të rimbursueshme; kosto për njësi 57.04 mije leke
- 13.500 paciente të trajtuar në spitalin e Durresit, kosto për njësi 57 mije leke
- Funksionimi i ISKSH
- 12 % e nevojave të plotësuar me investime
- 10000 paciente të trajtuar me ekzaminime të shtrenjta; 18 mije leke

111. **Objektivat e politikës për vitin 2011:**

- 10% e fshatrave e mbuluar me ambulanca çdo vit;
- 10% e totalit të infrastruktures të shërbimit stomatologjik publik e përmirësuar dhe 10% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit;
- 10% e QSH e plotësuar me pajisje zyre çdo vit;
- Rritje në masën 10% e kontributit të buxhetit të shtetit për sigurimin e kontrceptiveve në shërbimet publike të planifikimit familjar;
- Sistemi i informacionit në KSHP për 12 qarqe të integruar;
- Trajnimi i mjekut të familjes në 5 qarqe.

112. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2011:

- Femije deri ne 18 vjec te trajtuar ne sherbimin stomatologjik. Kosto per njesi 476 mije leke
- Funkcionimi i 36 strukturave te KSHP ne varesi te MSH8% e nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore
- 2% e nevojave te plotesuara me ambjente te rikonstruara ne QSH
- 3 projekte te mbeshtetura me kontributin e TVSH & detyrimi doganor
- 5 poliklinika te rehabilituara, kosto per njesi 100 milion leke
- 6% e nevojave te plotesuara me pajisje mobilimi dhe zyre
- 5.700.000 vizita te kryera ne njesite e kujdesit shendetesor paresor, kosto per njesi 1.4 mije leke
- 375 medikamente te rimbursueshme; kosto per njesi 12.9 milione leke
- 14000 paciente te trajtuar ne spitalin e Durresit, kosto per njesi 62.1 mije leke
- Funkcionimi i ISKSH
- 15% e nevojave me investime
- 11000 Paciente te trajtuar me ekzaminime te shtrenjta; 20.9 mije leke
- 2% e nevojave te plotesuara me ambjente te rikonstruara.

113. Standartet e Politikes:

- Ofrimi i KSHP ne nivel QSH:
- ne qytet 1 mjek per 2000 banore;
- ne fshat 1 mjek per 1700 banore;
- nje ambulance me infermier per çdo fshat (ku nuk ka mjek);
- Numri i mjekëve te familjes 1,3 mjekë per 1000 banore;
- 1 mjek stomatolog per 2500 popullate te grupmoshes 0-18 vjeç.

07330 Sherbimet e Kujdesit Dytesor

114. **Politika e ketij Programi** konsiston ne ofrimin e kujdesit mjekesor te specializuar nga strukturat perkatese per nje akses me te mire, cilesi dhe menazhim kosto-efektiv te ketij sherbimi. Permirsimi i cilesise se sherbimeve me anen e aplikimit te udhezuesve te praktikës klinike, sistemit te akreditimit, trajnimit te personelit, vleresimit te teknologjise mjekesore dhe te performances me ane te treguesve perkates.

115. Objektivat e politikës per vitin 2009:

- Ruajta dhe permiresimi i funksionimit te te gjithë strukturave te kujdesit spitalore me shtreter
- Plotesimi i nevojave per 50% te pacienteve me aktivitetet rehabilituese dhe integruese;
- Plotesimi 100% me barna dhe pajisje mjeksore (sipas nje seti te standardizuar) te sherbimit te urgjences mjeksore ne te gjithë vendin;
- Plotesimi 100% i nevojave te sherbimit obstetric dhe neonatologjik ne spitalet universitare dhe rajonale per barna, materiale mjekimi, pajisje mjeksore dhe orendi;
- Plotesimi ne masen 100% i nevojave baze ne sherbimet e shendetit mendor me shtreter;
- Dyfishimi i numrit te pacienteve te trajtuar me barna ne sherbimin e onkologjise si dhe hematologjise;
- Dyfishimi i proceseve diagnostike dhe terapeutike per pacientet me semundje koronare te zemres;
- Arritja e vetemjaftueshmerise kombetare me gjak me 25 000 dhurime vullnetare per vitin 2009;
- 20% e pacienteve te trajtuar me hemodialize dhe te gjithë komponentet e tjere.

116. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2009:

- 25% e nevojave te plotesuara me ambjente te rikonstruara
- 27 projektme te reja te bera; kosto per njesi 1.6 milione leke
- 22% e nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore
- 9% e nevojave te plotesuara me pajisje mobilimi dhe zyre
- 2 projeke te mbeshtetura me kontributin e TVSH & detyrimi doganor
- 36.000 paciente te trajtuar ne sherbimin e patologjise; kosto per njesi 95.28 mije leke

- 75.000 paciente te trajtuar ne sherbimin e kirurgjise; kosto per njesi 33 mije leke
- 61.000 paciente te trajtuar ne sherbimin e pediatrie; kosto per njesi 20 mije leke
- 68.000 paciente te trajtuar ne sherbimin e obstetri gjinekologji; kosto per njesi 21.5 mije leke
- 8000 pajisje dhe infrastruktura spitalore te mirembajtura; 87.6 mije leke
- Sherbime mbeshetese ne spitalet e vendit te siguruara
- Ndertimi i spitalit per semundjet interne ne QSUT (CEB)
- 240 paciente te trajtuar me hemodialize; kosto per njesi 150 mije leke
- 5% e nevojave te plotesuar me pajisje kompiuterike, elektrike dhe teknologjike

117. Objektivat e politikës për vitin 2010:

- Ruajta dhe permiresimi i funksionimit te te gjithë strukturave te kujdesit spitalore me shtreter
- Plotesimi i nevojave per 60% te pacienteve me aktivitetet rehabilituese dhe integruese;
- Plotesimi 100% me barna dhe pajisje mjeksore (sipas nje seti te standardizuar) te sherbimit te urgjences mjeksore ne te gjithë vendin;
- Plotesimi 100% i nevojave te sherbimit obstetrik dhe neonatologjik ne spitalet universitare dhe rajonale per barna, materiale mjekimi, pajisje mjeksore dhe orendi;
- Plotesimi ne masen 100% i nevojave baze ne sherbimet e shendetit mendor me shtreter;
- Dyfishimi i numrit te pacienteve te trajtuar me barna ne sherbimin e onkologjise si dhe hematologjise;
- Dyfishimi i proceseve diagnostike dhe terapeutike per pacientet me semundje koronare te zemres;
- Arritja e vetemjaftueshmerise kombetare me gjak me 30 000 dhurime vullnetare per vitin 2010;
- 30% e pacienteve te trajtuar me hemodialize dhe te gjithë komponentet e tjere.

118. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2010:

- 27% e nevojave te plotesuara me ambjente te rikonstruara
- 27 projektme te reja te bera; kosto per njesi 1.8 milione leke
- 23% e nevojave te plotesuara me pajisje mjeksore
- 9% e nevojave te plotesuara me pajisje mobilimi dhe zyre
- 2 projeke te mbeshetura me kontributin e TVSH & detyrimi doganor
- 40.000 paciente te trajtuar ne sherbimin e patologjise; kosto per njesi 90.68 mije leke
- 80.000 paciente te trajtuar ne sherbimin e kirurgjise; kosto per njesi 35.38 mije leke
- Paciente te trajtuar ne sherbimin e pediatrie
- 75.000 paciente te trajtuar ne sherbimin e obstetri gjinekologji; kosto per njesi 20.53 mije leke
- 8000 pajisje dhe infrastruktura spitalore te mirembajtura; 151.2 mije leke
- Sherbime mbeshetese ne spitalet e vendit te siguruara
- Ndertimi i spitalit per semundjet interne ne QSUT (CEB)
- 260 paciente te trajtuar me hemodialize; kosto per njesi 173 mije leke

119. Objektivat e politikës për vitin 2011:

- Ruajta dhe permiresimi i funksionimit te te gjithë strukturave te kujdesit spitalore me shtreter
- Plotesimi i nevojave per 70% te pacienteve me aktivitetet rehabilituese dhe integruese;
- Plotesimi 100% me barna dhe pajisje mjeksore (sipas nje seti te standardizuar) te sherbimit te urgjences mjeksore ne te gjithë vendin
- Plotesimi 100% i nevojave te sherbimit obstetrik dhe neonatologjik ne spitalet universitare dhe rajonale per barna, materiale mjekimi, pajisje mjeksore dhe orendi;
- Plotesimi ne masen 100% i nevojave baze ne sherbimet e shendetit mendor me shtreter;
- Dyfishimi i numrit te pacienteve te trajtuar me barna ne sherbimin e onkologjise si dhe hematologjise;
- Dyfishimi i proceseve diagnostike dhe terapeutike per pacientet me semundje koronare te zemres;
- 40% e pacienteve te trajtuar me hemodialize dhe te gjithë komponentet e tjere.

120. Produktet kryesore qe do te ofrohen ne 2011:

- 2% e nevojave te plotesuara me ambjente te rikonstruara

- 27 projektme te reja te bera; kosto per njesi 2.2 milione leke
- 24% e nevojave te plotesuara me pajisje mjekesore
